EKSKLUZIVE

Laboratori i heroinës në Has të Kukësit, zbardhen përgjimet e Ronit të Shijakut

Turku Cesuroglu, i shpallur në kërkim, u gjet i vdekur në Prishtinë. Dy turqit e një kosovar takuan kushërinjtë Hoxha

NGA ELTON QYNO

► FAQE 2-3

[SHQIPTARJA.com]

ÇMIMI 30 LEKË | VITI IX - NR. 18 (2541) | E PREMTE, 25-01-2019 | www.shqiptarja.com

ZBARDHET URDHRI

PD LEKE PER PROTESTUESIT, BASHA: TE PAGUHEN SHPENZIMET

Dokumenti i plotë për organizimin e protestës, mister burimi i financimit të shpenzimeve

BASHA KERKON NGA DEGET ARGUMENTA: "IDENTIFIKONI PROBLEMATIKAT LOKALE PER TE CILAT DUHET TE PROTESTOHET"

► FAQE 7



PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË
KRYETARI

Partia Demokratike e Shqipërisë

Nr. Prot. 5
D. 23/01/2019

UDHËZIM

"Mbi zbatimin e vendimit të datës 22/01/2019 të Kryesisë së PDSH për zhvillimin e protestave lokale dhe protestës së datës 16 Shkurt 2019".

ryetari i Degës dhe të deleguarit e Kryesisë së PDSH-së, janë përgjegjës për
izimin dhe mobilizimin e qytetarëve dhe anëtarëve të partisë, për
protestat lokale dhe Protestën e Madhe të datës 16
0, n ranë.

për secilin Qark (sipas
Aneksin 1,
guarve në
nsus mes
caktohet
protestën dhe për çështje të tjera statutore.
Organizimin e protestave lokale për të cilën do merren vendime, si
ku të identifikohet problematika lokale për të cilën do
dhe duke sugjeruar tematikën, formën, gadishmërinë
mundshme kur mund të zhvillohet midis datave 2-12 Shkurt 2019, si dhe
vendin. Nën kujdesin e të Deleguarit, disa Degë brenda Qarkut mund të
organizojnë protesta të përbashkëta, ku Degët mbështesin njëra-tjetrën. Në
cdo rast, me kërkesë të të deleguarit, një Degë brenda Qarkut, mbështet
protestën e Degës tjetër brenda Qarkut. Degët e Tiranës do të koordinohen
së bashku për protestat lokale në Tiranë, për të njëjtën periudhë 2-12
Shkurt 2019.

ii. **Përgatitja për pjesëmarrje në Protestën e madhe më 16 Shkurt 2019, ora 11:00**, në Tiranë përpara Kryeministrisë.

ii.1.Organizimi i punës për takimet derë më derë në nivel seksioni dhe grupseksioni, dhe formatet përshtatshme për të ftuar dhe siguruar pjesëmarrjen e anëtarëve dhe qytetarëve të tjerë në Protestën e Madhe në Tiranë, apo në protestat lokale.

ii.2.Parashikimi i pjesëmarrjes në nivel grupseksioni dhe në nivel Dege, si dhe të merren masa për evidentimin e pjesëmarrjes me qëllim vlerësimin e kontributeve.

ii.3. Përcjellja e mesazhit te qytetarët për sigurimin e pjesëmarrjes maksimale me të gjitha format, takime me strukturat, takime me qytetarët derë më derë, ture të Kryetarit, fletushka, njoftime në rrjetet sociale, njoftimit me sms apo telefonata, etj;

ii.4. Përgatitja e logjistikës për transportin dhe shpenzimet në ditën e protestës; caktimi i vendit të nisjes nga Dega; propozimi i vendin dhe orës së takimit të degës pranë Kryeministrisë.

ii.5.Caktimi i datës, orës dhe vendit të mbledhjes së Aktivit të Degës.

ii.6.Ndarja e të Deleguarve dhe anëtarëve të Kryesisë së Degës në zonë.

PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË, Bulevardi Zhan D'Ark, Nr 11, Tiranë

SURPRIZAT E VETINGUT

Anëtari i Gjykatës së Lartë që ka 'jetuar' me 170 lekë në ditë

KPK pranoi koston e ulët të jetës të Edmond Islamajt duke e konfirmuar në detyrë, Komisioneri Publik kundër, vendimi përfundimtar do merret nga Kolegji i Apelimit

► FAQE 4

NGA ADRIATIK DOÇI

KËNDI I EKSPERTIT

Kepi: Pensionet familjare, kush i përfiton dhe si llogariten

Eksperti sqaron se çfarë janë pensionet familjare, dokumentet që duhen dhe rastet e përfitimit

► FAQE 11

PROJEKTLIGJI

Biznesi i vogël me TVSH e OJF-të detyrim për të hapur llogari bankare

► FAQE 8

NGA GENC KONDI

URDHRI I STOMATOLOGUT

Klinikat dentare dyfishojnë çmimet, MSH: Vendimi i pa aplikueshëm

► FAQE 10

STUDENTET

NIS REKRUTIMI NE AKADEMINE E POLICISE, JA KRITERET

► FAQE 9

Zbardhet urdhri, Ministria e Brendshme njofton fillimin e procedurave për rekrutimin e 100 studentëve. Si bëhet përzgjedhja e kandidatëve, kushtet që duhet të plotësojnë dhe degët e studimeve që preferohen

Cyan magenta yellow black

Zbardhen përgjimet e Ronit të Shijakut, ju gjet presa me heroinë në banesë

Dy turqit e një kosovar takuan kushërinjtë Hoxha. Turku Cesuroglu u gjet i vdekur në Prishtinë

Elton Qyno
TIRANE

Dy shtetasit turq Iskender Sale, Nejdet Cesuroglu dhe një Kosovar me emrin Xhemal Shalla, dyshohet se kanë mbërritur në Shqipëri, me qëllim zhvillimin e një takimi me Admir dhe Hekuran Hoxhën, që të dy djem xhaxhallarësh, që dyshohen nga Krimet e Rënda si personat që trafikonin sasi të konsiderueshme heroine nga Turqia në vendet e Europës. Qëllimi i këtij takimi sipas të dhënave të prokurorisë ishte përcaktimi i një vendi në zonën e Durrës, ku do fshinin heroinën dhe pikërisht nga ku do e përpunonin dhe trafikonin nëpërmjet portit të Durrësit drejt vendeve të BE. Për sjelljen e sasisë së heroinës në Durrës, dy kushërinjtë Roni Hoxha dhe Admir Hoxha, i shpallur në kërkim, flasin së bashku për rregullimin e disa letrave, për diçka në Durrës. Kjo bisedë është zhvilluar në muajin Gusht të 2018 ndërkohë gjatë kësaj periudhe deri në Tetor, Hoxha mban kontakte me disa persona nga Kosova dhe Saimir Gjepalin, ku komunikon për disa detyrime financiare ku përmendet shifrat 800 dhe 500. Ndërkohë pas shumë bisedave, kushëriri i tij Admir Hoxha në tetor 2018 flet me një person, i cili e ve në dijeni se ka ardhur në Shqipëri një shtetas Kosovar dhe dy shtetas Turq, që sipas prokurorisë janë dy shtetasit turq Iskender Sale, Nejdet Cesuroglu dhe Kosovari Xhemal Shalla. "Shqiptarja.com" zbardh sot të plota përgjimet e Ronit të Shijakut dhe kushëririt të tij Admir Hoxha. Sipas prokurorisë këta dy persona janë dy drejtuesit e grupit kriminal, dhe personat përgjegjës që kishin organizuar futjen në Shqipëri nga Kosova të 161 pakove me heroinë. Sasia e drogës, ishte fshehur në një shtëpi në një nga fshatrat e Hasit në Kukës, dhe prej këndej po planifikohej të transportohej në Durrës, ku ishte siguruar një ambjent për përpunimin e saj. Prej këndej, sasia e drogës do trafikohej në Itali.

TURKU GJENDET I VDEKUR NË PRISHTINË

Por në dokumentin e prokurorisë së Krimeve të Rënda thuhet se një nga shtetasit Turq të shpallur në kërkim me vendim gjykate, është gjetur i vdekur në një banesë në Prishtinë. Nejdet Cesuroglu, është gjetur i pajetë nga policia Kosovare, e cila gjatë një operacioni të përbashkët me Prokurorinë Shqiptare ka hyrë në një shtëpi në Prishtinë, ku ka sekuestruar 113.5 kg lëndë narkotike heroinë dhe ka arrestuar Kosovarin Xhemal Shalla dhe turkun Iskender Sale. Por gjatë kontrollit të banesës është gjetur dhe trupi i pajetë i Nejdet Cesuroglu. Ky i fundit nuk ka pasur shenja dhune, apo plagë në trup të shkaktuara nga armë zjari, por hetuesit kosovarë kanë ngritur dyshime se mund të kenë ndëruar jetë si pasojë e overdozës ose ndonjë ataku kardiak në zemër.

OPERACIONET E ARRESTIMEVE

Ky operacion në Kosovë është realizuar në fillim të dhjetorit 2018, ndërkohë në 17 janar 2019 në Shqipëri prokurori Vladimir Mara, urdhëroi policinë e Shtetit të arrestonin Hekuran Hoxhës, pasi nga të dhënat operative, ai kishte planifikuar të udhëtonte jashtë shtetit me qëllim largimin dhe fshehjen nga drejtësia. Gjatë operacionit policor për arrestimin e "Ronit të Shijakut", policia ka sekuestruar një presë identike me ato që shërbejnë në laboratorët e heroinës për paketimin dhe presimin (ngjeshjen) e heroinës. Pikërisht në këtë presë metalike, është konstatuar përmbajtje të heroinës, një mostër e së cilës është analizuar. Për të shuar çdo dyshim që Hekuran Hoxha ka lidhje me 161 pakot e heroinës të sekuestruar në Has, prokurorët kanë urdhëruar ekspertimin e dy mostrave të heroinës së sekuestruar në Has dhe në Presën e gjetur në banesën e Hekuran Hoxhës.

Hekuran Hoxha

Ndër të tjera, nga transkriptimi i përgjimeve mes Ronit dhe Admir Hoxha, në datën 30 gusht 2018, ndër të tjera është zhvilluar kjo bisedë:

Roni: Ka je?

Admir: Hiq... në Tiranë

Roni: E qa do bëjmë do takojmë sot

Admir: Po thanë, e lamë me këtë shokun tim se ka gjet ky ni ashtu aty n'Durrës që merr vesh nga këto letrat

Roni: Okej... rregullojmë njëherë letrat...

Roni: Mirë... shife vetë edhe ashtu, po me atë ke fol me të

Admir: Jo mor burrë s'kam fol u ba nja një javë ni javë u ba... hajt se folim nga afër...

Komunikim ndërmjet numrit 069XXX50

AKUZAT E PROKURORISË	
1.	"Prodhimi dhe shitja e narkotikëve"
2.	"Trafikimi i narkotikëve"
3.	"Prodhimi dhe fabrikimi i lëndëve narkotike dhe psikotrope", në bashkëpunim në formën e posaçme të grupit të strukturuar keiminal
4.	"Grupi i strukturuar kriminal"
5.	"Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal"
6.	"Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale".

Takimi

Qëllimi i këtij takimi sipas të dhënave të prokurorisë ishte përcaktimi i një vendi në zonën e Durrës, ku do fshinin heroinën dhe pikërisht nga ku do e përpunonin dhe trafikonin nëpërmjet portit të Durrësit drejt vendeve të BE.

Operacioni antidrogë nxori zbuluar pesë grupe kriminale në vend

Në vendimin e Gjykatës së Krimeve të Rënda, të zbardhur nga "Shqiptarja.com", me 44 urdhër-arresti rezulton se ka lidhje mes disa organizatave kriminale më në ze në vend të shtrira nga Jugu në Veri. Rezulton se qendra e trafikut të Kokainës dhe Heroinës nga Amerika Latine drejt vendeve të Bashkimit Evropian ishte në Shijak e Maminas, ndërsa për kanabisin ishin të angazhuara dhe organizatat e tjera kriminale në vend. Në dokumentet ekskluzive, Prokuroria ka ndërtuar lidhje mes organizatës kriminale të Avdylajve në Shijak,Hoxhave në Shijak, Bajrave në Shkodër dhe Ndokajve në Lezhë. Sipas Prokurorisë në krye të kësaj superorganizate ishte Astrit Avdyli i njohur edhe si Astrit Balliu dhe merreshin me trafikun e sasive të mëdha droge nga Shqipëria drejt Italisë e më pas drejt vendeve të BE-së. Pjesë e kësaj organizate, thekson prokuroria janë edhe personazhe të tjerë të njohur të botës së krimit si Safet Bajri, Astmer Bilali, Astrit Keçi, Gerald Keçi, Gjevi Ndoka e Danjan Ndoka. Kjo dosje ka filluar të ndërtohet në dhjetor 2016, ku në Kavajë janë arrestuar shtetasit Ramadan Shabani, Enerd Duka, Marjus Xhihani etj, persona këta tashmë të dënuar nga gjykata e Kavajës. Më pas çështja ka vijuar me ndjekjen e një rasti tjetër të trafikut të drogës,ku kësaj superorganizate i është bërë kapja në Itali më 8 shkurt 2017, e 2 ton kanabis ku u arrestuan transportuesit Ermal Agaj dhe Avni Dhrami. Sipas prokurorisë, në rastin e këtij trafikimi janë përfshirë veç të tjerëve edhe Astrit Avdyli, i njohur si bosi i Shijakut dhe Gjevi Ndoka,vëllai i ish-deputetit të PS Arben Ndokës. Këto lidhje mes Astrit Avdylit, Gjevi Ndokës dhe fierakëve Petrit e Saimir Sulejmani dalin prej përgjimeve që u janë bërë

Prokuroria kërkoi arrestimin e 44 personave

komunikimeve të tyre telefonike. Gjatë hetimeve të kësaj dosje kanë rezultuar të dhëna se disa shtetas ndër ta dhe Astrit Balliu ose Avdyli, merreshin me trafikimin e sasive të mëdha lëndësh narkotike nga Shqipëria në drejtim të shtetit Italian, dhe vendeve të tjera Europiane. Gjithashtu fillimisht u identifikuan disa shtetas si bashkëpuntorë të Astrit Balliut,të cilit ishin Altin Avdyli, si dhe personat e tjerë kumunikuesit dhe lidhje e tyre identifikuar si shtetas Esat Mehmeti, Astrit Keçi, Gerald Keçi, Saimir Gjepali (Shaqo),Daut Çemani (Dadi), Shkëlqim Sufja, Danjan Ndoka, Fatos Llaftiu, Safet Bajri, Astmer Bilali si dhe personave të tjerë tjerë që hyjnë rrishtazi në këtë veprimtari kriminale. Gjithashtu persona të tjerë të përfshirë në këtë veprimtari kriminale është dhe Jasin allias Avdyli, Shkëlqim Avdyli, si dhe një sërë bashkëpuntorësh të tyre si Denis Llatfiu, Ardit Gjyriqi, Klajdi Llatfiu, Hajri Seferi dhe persona të tjerë si bashkëpuntorë.Pikënisje e zbulimit të kësaj superorganizate është bërë kapja në Itali më 8 shkurt 2017 e 2 ton kanabis ku u arrestuan transportuesit Ermal Agaj dhe Avni Dhrami. Sipas prokurorisë, në rastin e këtij trafikimi janë përfshirë veç të tjerëve edhe Astrit Avdyli, i njohur si bosi i Shijakut dhe Gjevi Ndoka, vëllai i Arben Ndokës. Këto lidhje mes Astrit Avdylit, Gjevi Ndokës dhe fierakëve Petrit e Saimir Sulejmani dalin prej përgjimeve që u janë bërë komunikimeve të tyre telefonike. Në konkluzionet e saj Prokuroria shprehet se shtetasit Astrit Avdyli, Altin Avdyli në lidhje me Gjevi Ndokën, Danjan Ndokën dhe të tjerë kryejnë trafik të lëndëve narkotike, kokainë dhe heroinë dhe Kolumbia dhe Peruja për shpërndarje në shtetet europiane si Holanda, Gjermania, Franca etj.

me numri +333 në përdorim të Hekuran Hoxhës në 14gusht 2018 ku i dërgon sms me tekst:

"...O shok po më vjen Dori përditë... kam për t'i dhonë 800...".

Ndërkohë në një tjetër komunikim mes Saimir Gjepalit dhe Ronit të Shijakut, Gjepali i dërgon sms me tekst:

"...o shok në dark do shkoj te ai se se nuk erdhi knejr. hë shok a vonohesh? A ikim bashkë? I tha do vij të takoj e kemi lon në 9 e gjys për zotin. o shok s'ka ardh akoma...?".

Ndërsa në një komunikim tjetër të datës 12 shtator 2018 me një person të paidentifikuar i vjen ky mesazh:

"...jam në Kosovë vij vonë nga darka...".

Më pas një person i paidentifikuar i dërgon një sms Hekuran Hoxhës, ku i thotë:

"...o Rono më erdh Dori ke puna osht dhy puna keq po s'më dhe lekët deri sonte nesër i du gjith më tha. e kam litarin n'fyt. o shok a bane noj gjo për atë 500 paktën t'i jap atë...".

Roni: Nesër kismet shok....

Komunikon mee numrin 069XXX784, ku ky i fundit i dërgon në datën 14.08.2018 sms:

"Të them unë se munt të hiki në Lezh me kët shokun dhe kthehem direkt në Tiranë po nuk hika hikim bashkë".

Sërisht Ronit i shkruar një person tjetër ku i flet për një borxh financiar duke i shkruar në 14 gusht 2018:

"amon mer shok të kishim maru punë se kam dal legen me atë e kam majt gjith ditën tel të fik".

Roni i kthen sms: "ke të drejt, e di er shok kam dal dhe unë legen me ty. sa të vij të mar unë".

Ndërsa sipas transkripimit të përgjimeve të datës 17 tetor 2018, ndërmjet Admir Hoxhës dhe një personi tjetër, në kohën kur kishin ardhur shtetasit nga Turqia dhe shtetasi kosovar zhvillohet kjo bisedë:

Admir: alo o flori si kalove nesër vijnë ca miq të mij aty thuaju të ulen në kafe...

+544: do vijnë ca miq tuj dhe do shkojnë te kafja....

Admir: thuaju të ulen te kafja...

+544: Ado erdhën këta tre shokët unë po ju flas anglisht por s'po më kuptojnë

Admir: m'i jep në telefon

+544: po (nga ana e OPGJ-ë është lënë shënimi se personat flasin turqisht me Adin).

Trupi i pajetë

Por gjatë kontrollit të banesës është gjetur dhe trupi i pajetë i Nejdet Cesuroglu. Ky i fundit nuk ka pasur shenja dhune, apo plagë në trup të shkaktuara nga armë zjari, por hetuesit kosovarë kanë ngritur dyshime se mund të kenë ndëruar jetë si pasojë e overdozës ose ndonjë ataku kardiak në zemër.

PRETENDIMI I AVOKATIT

Pavarësisht këtyre pretendimeve të prokurorisë dhe provave të administruara prej saj, kundër Hekuran Hoxhës, avokati i këtij të fundit ka pretenduar në gjykatë se klienti i tij nuk ka rrezik ikje, dhe për këtë i ka kërkuar gjykatës caktimin e një mase më të butë. Sipas avokatit Hekuran Hoxha, që para tre muajve ka ardhur në dijeni të kontrollit të banesës së tij, dhe ai nuk është larguar deri më tani. Sipas avokatit, Hekuran Hoxha është i sëmurë, i është nënshtruar ndërhyrjeve kirurgjikale në zemër, ai është biznesmen. Ndërsa Admir Hoxha e ka pasur të punësuar prej shumë kohësh në biznesin e tij, po kështu Hekuran Hoxha mund të ketë komunikuar me Saimir Gjepalin, pasi e ka komshi dhe janë rritur bashkë dhe nuk ka dijeni se me çfarë merret. Lidhur me lëndën narkotike që i është gjetur Saimir Gjepalit, për këtë është dënuar vëllai i tij dhe nuk ka lidhje me faktet që përmend Prokurori. Më tej avokati mbrojtës i Hoxhës thotë se ditën e ngjarjes personi Hoxha ka qenë te biznesi i tij. Hekuran Hoxha deklaroi se në vitin 2013, i ishte nënshtruar një ndërhyrjeje kirurgjikale, duke vënë dy stenda, dhe më pas për këtë Gjykata e Durrësit e kishte liruar me kusht, pasi i rrezikohej jeta në burg. Lidhur me faktin penal që i atribuonte Prokuroria, Hoxha ka pohuar se nuk kishte asnjë lidhje, duke shtuar se ai nuk mund të akuzohej pa asnjë provë. Admir Hoxhën e kishte djalë xhaxhai dhe e kishte pasur të punësuar, prandaj mund të kishte pasur telefonata. Po kështu edhe me Saimir Gjepalin, duke e pasur komshi dhe shok mund të kishte pasur telefonata, por ai nuk kishte kryer asnjë vepër penale.

Ekspertimi

Për të shuar çdo dyshim që Hekuran Hoxha ka lidhje me 161 pakot e heroinës të sekuestruar në Has, prokurorët kanë urdhëruar ekspertimin e dy mostrave të heroinës së sekuestruar në Has dhe në Presën e gjetur në banesën e Hekuran Hoxhës.

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Anëtari i Gjykatës së Lartë që ka 'jetuar' me 170 lekë në ditë

KPK pranoi koston e ulët të jetës të Edmond Islamajt duke e konfirmuar në detyrë, Komisioneri Publik kundër, vendimi përfundimtar do merret nga Kolegji i Apelimit

Adriatik Doçi
TIRANE

Anëtari i Gjykatës së Lartë Edmond Islamaj, për të justifikuar paratë e kursyera, pretendon se ka jetuar me 5 mijë lekë në muaj ose 170 lekë në ditë, gjatë periudhës kohore 1992 deri në vitin 2000. Ky standard jetese është pranuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, organi bazë i Vetingut, në vendimin për konfirmimin në detyrë të gjyqtarit Edmond Islamaj. Në analizën financiare, KPK thekson se shpenzimet e jetesës për periudhën 1992-2000 të Edmond Islamajt janë në shumën 480,000 lekë, mesatarisht 5,000 lekë në muaj. "Nga analiza financiare për periudhën 1992-2000, rezulton se: Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar apartament banimi, me sipërfaqe 81.54 m², përfituar nga privatizimi i ish-banesave shtetërore në vitin 1993, ndodhur në Durrës. Shpenzimet e jetesës për periudhën 1992- 2000 janë në shumën 480,000 lekë (Për periudhën 1992-2000 është marrë si mesatare shuma prej 5,000 lekësh/muaj shpenzime jetese



për subjektin). Të ardhurat e subjektit për periudhën 1992-2000, referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion në total, janë 1,822,161 lekë", thuhet në vendimin e KPK. Nga këto para, sipas KPK, gjyqtari ka çelur një depozitë në vitin 2000 me vlerë 5,191 euro, u janë llogaritur shpenzime jetese 480,000 lekë, ndërsa diferenca e mbetur për shpenzime të tjera është 653,880 lekë. Si përfundim, në vendim thuhet se 'trupa gjykuese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konstaton se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të lartë të vlerësimit të aftësive profesionale".

KOMISIONERI PUBLIK KUNDËR KPK

Në qershor të vitit 2018, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit vendosi të konfirmonte në detyrë anëtarin e Gjykatës së Lartë Edmond Islamajn. Ndërkaq, Komisioneri Publik, në 11 korrik të 2018, i kërkoi Kolegjit të Posaçëm të Apelimit ndryshimin e vendimit të KPK dhe një hetim më të thelluar për pasurinë e gjyqtarit. Arsyeja e ankimit nuk ishte llogaritja e kostos së jetesës së gjyqtarit për vitit 2000, por disa pasuri të gjyqtarit, të cilat sipas Komisionerit Publik nuk justifikohen apo që nuk janë deklaruar. Komisioneri Publik thekson se gjyqtari ka blerë 1 mijë metra katrorë tokë kullotë për 137.000 lekë, me çmim më të ulët se vlera e tregut. "Shitësi, përpara tjetërsimit të pronësisë te subjekti, nga shënimet e dokumenteve hipotekore, rezulton se e regjistron për herë të parë këtë pronë në emër të tij në datë ***.2.2015 dhe në datë ***.3.2015 ia shet subjektit të rivlerësimit", thuhet në ankimim. Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka nisur një hetim të thelluar për gjyqtarin pas ankimimit nga ana e Komisionerit. Seanca e radhës gjyqësore dhe ndoshta e fundit është në datën 29 janar.

TRE PASURI TË BASHKËJETUESES TË PADEKLARUARA

Komisioneri Publik thekson gjithashtu se gjyqtari Edmond Islamajn nuk ka deklaruar më parë, por vetëm në deklaratë e pasurisë për Vetingut, tre pasuri të bashkëjetueses, të cilat i disponon që nga vitit 2001. "Megjithëse në cilësinë e bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit, znj...., prej vitesh (v. 2005 deklarimi i parë) kryen deklarimin e pasurive dhe interesave privatë, pronësia e saj mbi këto pasuri të paluajtshme, që referohet se është fituar që në vitin 2001, nuk është deklaruar asnjëherë dhe deklarohet për herë të parë vetëm në deklaratën "Vetting" në vitin 2017. Konkretisht, znj...deklaron: "Apartament", me sipërfaqe 141.13 m2; "Njësi"/ambient tregtar, me sipërfaqe 55 m2; "Garazh", me sipërfaqe 16 m2", pretendon Komisioneri Publik.

MAKINA 20 MIJË EURO

Komisioneri Publik ngre dyshime edhe mbi burimin e parave për blerjen e një makine 20 mijë euro nga gjyqtari, i cili pretendon se 60 % e shumës është paguar nga babai i tij, i cili nuk jeton më. "Në vitin 2014, katër vite pas blerjes, subjekti i rivlerësimit, duke nënshkruar dhe në emër të atit të tij, i shet automjetin për një vlerë prej 20.000 euro. Bazuar në përmbajtjen e kontratës, noteri e ka konsideruar të atin e subjektit të rivlerësimit si të përfaqësuar nga ky i fundit, por nga aktet e administruara nuk rezulton asnjë prokurë që të legjitimojë këtë përfaqësim", arsyeton Komisioneri Publik.

PASURI NË EMËR TË FËMIJËVE

Fëmijët e mitur të gjyqtarit kanë në pronësi një pasuri të paluajtshme ndërtesë dhe truall, të dyja me të njëjtën sipërfaqe prej 106.7 m2, dhuratë nga gjyshërit. Sipas Komisionerit Publik "nga përmbajtja e dokumentacionit bankar, përshkrimet e mandatpagesave, rezulton se (babai i bashkëjetueses së subjektit) dhe (babai i subjektit të rivlerësimit) rezulton se kanë hyrë në marrëdhënie huamarrje mes tyre, ku ky i fundit i ka marrë hua shumën 3.000.000 lekë z..., për blerjen e pasurisë, e cila më pas iu dhurua fëmijëve të mitur të subjektit të rivlerësimit. Komisioni, ka pyetur z..., si person i lidhur që ka dijeni. Nga procesverbali i datës.... mohon t'i ketë dhënë borxh shumën 3.000.000 lekë z...., duke pretenduar se është banka që ka gabuar, duke pohuar ..."ne s'kemi pasur fare lekë"".

NUK JUSTIFIKOJNË KURSIMET

Komisioneri Publik pretendon se për vitet 2005, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2015 na rezulton se gjyqtari dhe bashkëjetuesja nuk justifikojnë me të ardhura të ligjshme kursimet e deklaruara në deklaratat vjetore të interesave privatë. "Në total kjo vlerë e diferencës së pambuluar të kursimeve cash shkon në vlerën minus 4.466.990 lekë. Nuk rezulton të jetë konstatuar dhe hetuar nga Komisioni pamundësia financiare e subjektit për të mbuluar kursimet e deklaruara për vitet si më sipër me burime të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3, i aneksit të Kushtetutës, apo dhe saktësia e deklarimit për vitet të cilat rezultojnë me diferencë negative në mbulimin e kursimeve me të ardhura të ligjshme, në kuptim të nenit 32/5, të ligjit nr. 84/2016", arsyeton Komisioneri.

Detajet

KOSTOJA
Sipas vendimit të Komisionit të Vetingut, anëtari i Gjykatës së Lartë Edmond Islamaj ka jetuar me 5 mijë lekë në muaj ose 170 lekë në ditë, gjatë periudhës kohore 1992 deri në vitin 2000.

KOMISIONERI
"Për vitet 2005, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2015 na rezulton se gjyqtari dhe bashkëjetuesja nuk justifikojnë me të ardhura të ligjshme kursimet e deklaruara në deklaratat vjetore të interesave privatë".

Gjyqtari duhet të justifikojë udhëtimet jashtë vendit

Anëtari i Gjykatës së Lartë Edmond Islamaj duhet të justifikojë para Kolegjit të Posaçëm të Apelimit edhe burimin e shpenzimeve për udhëzime jashtë vendit për periudhën 2004-2008, në të kundër rrezikon shkarkimin nga detyra. Në seancën e fundit gjyqësore të zhvilluar në 22 janar, Kolegji Apelimit u dorëzoi Edmond Islamajt dhe Komisionerit Publik një kopje e të dhënave nga sistemi TIMS për hyrje-daljet nga territori i Shqipërisë për Edmond Islamajn dhe personave të lidhur me të, për periudhën 1 janar 2004 deri në 1 janar 2008, të dhëna këto që autoritetet shtetërore i vunë në dispozicion Kolegjit. Trupi gjykues i kërkoi subjektit të rivlerësimit që pasi të njihet me dokumentacionin, të përcaktojë

se cilat udhëtime janë bërë për shkak të pozitës zyrtare dhe cilat për qëllime private. Islamaj kërkoi kohë për të bërë ndarjen e udhëzimeve që kishte bërë për shkak të detyrës me udhëtimet private. Kolegji i Apelimit i ka lënë kohë gjyqtarit deri në datën 29 janar, kur do të zhvillohet edhe seanca e radhës gjyqësore.

ANALIZA FINANCIARE E KPK PËR ISLAMAJN 1992-2000
1992, 11,400 lekë
1993, 19,334 lekë
1994, 20,857 lekë
1995, 97,626 lekë
1996, 269,208 lekë
1997, 269,208 lekë
1998, 286,181 lekë
1999, 429,242 lekë
2000, 419,106 lekë
Totali 1,822,161 lekë
Depozitë në vitin 2000, 5,191.44 euro
Shpenzime jetese, subjekti 480,000 lekë
Diferenca e mbetur për shpenzime të tjera 653,880 lekë

CORRECTOR
BAILIFF SERVICE

SHPALLJE ANKANDI

SHOQËRIA PËRMBARIMORE "CORRECTOR" SHPK, ZHVILLON ANKANDIN E II-TË, PËR SHITJEN E PASURISË SË PALUAJTSHME

1- Truall+Ndërtesë 460.8 m2 në Budull Krujë, ZK 1299, nr. 473/21, vol. 11, fq. 122, në pronësi të Rasim Gjika – LEKE 14,000,000 (katërmbëdhjetë milion lekë)

2- Truall+Ndërtesë 209.5 m2 në Lgj. "Kastrioti", Fushë-Krujë, ZK 1664, nr. 2/147+5-5, vol. 5, fq. 48, në pronësi të Rasim Gjika – LEKE 8,400,000 (tetë milion e katërqind mijë lekë)

3- Arë+Truall+Ndërtesë 3120 m2 në Mazhë Madhe Krujë, ZK 2621, nr. 22/5, vol. 1, fq. 10, në pronësi të Bilal Sadik Daci – LEKE 6,160,000 (gjashtë milion e njëqind e gjashtëdhjetë mijë lekë);

4- Arë 9580 m2 në Mazhë Madhe Krujë, ZK 2621, nr. 22/22, vol. 5, fq. 103,në pronësi të Bilal Sadik Daci – LEKE 2,688,000 (dy milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e tetë mijë lekë);

Ankandi zhvillohet dt. 21/02/2019, në adresën, Rruga e Kavajes, Ndertesa 27, Hyrja 1, Kati i III –te, Tiranë.

KONTAKT: CEL. 0684000061 OSE NË ADRESËN E E-MAIL: ARMELS.LOLE@NCHB.AL

PROJEKTI / NIS PUNA PËR AKTIVIZIMIN E BAZËS SË KUÇOVËS

Avionë të NATO-s koreografi në qiellin e Tiranës

Avionët
Qielli i Tiranës u vizitua dje nga avionët e NATO-s të në shenjë nderimi dhe mbështetjeje për përmbushjen e misionit të Shqipërisë në Aleancë. Shfaqja në ajër filloi rreth orës 11:00.

Qielli i Tiranës u vizitua dje nga avionët e NATO-s të në shenjë nderimi dhe mbështetjeje për përmbushjen e misionit të Shqipërisë në Aleancë. Shfaqja në ajër filloi rreth orës 11:00 në qiellin e Tiranës, dhe pikërisht në këtë kohë momenti i fluturimit të avionëve u shijua nga të pranishmit në ceremoni, por edhe kalimtarët në rrugë. I pranishëm në ceremoninë e djeshme ishte edhe komandanti i NATO-s, Gjeneral Tod Wolters, i cili ka ardhur në Shqipëri për të zyrtarizuar nisjen e investimit për të riaktivizuar bazën Ajrore të Kuçovës. Ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka pati lajmëruar se në qiellin e Tiranës do të fluturonin 5 avionët e NATO-s, mes tyre edhe AËACS (Avioni i veçantë i NATO-s me sistem radari në bord). Ky avion do të vinte nga Gjermani dhe do të fluturonte mbi Tiranë por për shkak të motit të keq me akull ardhja e tij nuk u bë e mundur. Edhe pse ekipi atje u përpoq të nisej kushtet atmosferike e bënin të pamundur, ndërsa në Tiranë fillimisht u dha sinjali se avioni do të vonohej rreth 1 orë e 30 minuta. Por pas u dha njoftimi se fluturimi u anulua. Në muajin gusht të vitit 2018, u dha lajmi se NATO do të ndërtojë bazë ajrore në Kuçovë, në bazën e vjetër ajrore, ku tashmë qëndrojnë avionë luftarakë. Baza ajrore e Kuçovës do të shndërrohet në bazën e parë të NATO-s në Ballkanin Perëndimor. Aty do të zbarkojnë avionët luftarakë modernë të NATO-s, F-16, pasi baza ajrore të jetë transformuar. NATO ka planifikuar një investim fillestar për 50 mln euro për shndërrimin e saj në bazë ajrore moderne nga ku do të patrullohet dhe kontrollohet hapësira ajrore jo vetëm e Ballkanit, por edhe e Evropës.

Gjenerali i NATO-s: Ja përse zgjodhëm bazën ajrore të Kuçovës

Wolters: Forcat shqiptare të rëndësishme për NATO-n, privilegj bashkëpunimi me ju

Komandanti i Komandës Ajrore të NATO gjeneral Tod D. Wolters, po zhvillon një vizitë në Tiranë, për të shënuar fillimin e zbatimit të paketës, që NATO ka parashikuar të investojë në Bazën Ajrore të Kuçovës, gjatë 5 viteve të ardhshme. Vizita e gjeneral Wolters në vendin tonë shënon edhe fillimin e aktiviteteve për këtë vit që përkon me 10-vjetorin e anëtarësimit të Shqipërisë në NATO. Fillimisht gjeneral Wolters u prit me truprojë nderi nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, ndërsa më pas nga ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka. Gjatë një konference për shtyp me ministren Xhaçka, gjenerali i NATO-s, foli për arsyet se pse u zgjodh Baza e Kuçovës për t'u shndërruar në një bazë ajrore të NATO-s. "Mund të flas për Kuçovën, Kuçova ka karakteristika të veçanta, një pistë ekzistuese me një infrastrukturë të mrekullueshme, që ndodhet në një pozicion gjeografik të përshtatshëm në lidhje me vendin tuaj dhe me Ballkanin Perëndimor. Gjithashtu është një pozicion gjeografik që na ofron neve mundësi shumë të mira atmosferike të motit duke mundësuar ngritjen dhe uljen çdo ditë të avionëve në Kuçovë falë kushteve natyrore atmosferike të shkëlqyera", tha Wolters.

Tod Wolters
"Është një pozicion gjeografik (Kuçova) që na ofron neve mundësi shumë të mira atmosferike të motit duke mundësuar ngritjen dhe uljen çdo ditë të avionëve në Kuçovë falë kushteve natyrore atmosferike të shkëlqyera".

VLERËSIM PËR ROLIN E SHQIPËRISË

Gjenerali i NATO-s, Tod Wolters, ë fjalën e tij, ai vlerësoi rolin dhe kontributin e Shqipërisë në NATO duke u shprehur i emocionuar për bashkëpunime të mëparshme. "Ndihem mjaft i nderuar që jam mes jush dhe i emocionuar që ndodhem në krah të një partneri të madh të NATO. Vështirë ta imagjinosh që vetëm dhjetë vite më parë, në pranverën e 2009-s, vendi juaj i mrekullueshëm u bë pjesë e aleancës dhe ja ku jemi vetëm dhjetë vite më vonë, festojmë nisjen e punës për përmirësimin infrastrukturor të bazës ajrore të Kuçovës. Ajo çfarë presim të ndodhë gjatë muajve dhe viteve të ardhshme është përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës dhe çfarë do të ndodhë padyshim është që do të kemi një strehë ajrore në Kuçovë dhe jemi vërtet tepër të emocionuar për çuarjen para të kësaj kauze, sikurse edhe ky komb i mrekullueshëm dhe gjithashtu jemi të emocionuar për vrullin e kësaj fushate, çka e dëshmojmë edhe nga Shtabi i Komandës Ajrore të NATO, në lidhje me Forcat e Armatosura të Shqipërisë, forcë që ka ndikim tepër të fortë në një zonë të gjerë, që shtrihet nga ky kryeqytet në drejtim të Jugperëndimit dhe Juglindjes deri në Afganistan dhe Mali, e shtrihet deri në Veri, në Letoni dhe duke u kthyer në Kosovë dhe këtu, në këtë kryeqytet", tha ai.

Xhaçka
"Baza Ajrore e Kuçovës do të jetë së shpejti një bazë e NATO-s. Shqipëria është një vend i sigurt, ku Aleanca do të investojë kapacitetet e saj. Investimi i NATO-s në Kuçovë është i rëndësishëm jo vetëm për sigurinë kombëtare".

OLTA XHAÇKA

Në një konferencë për shtyp ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka bashkë me gjeneralin e NATO-s, Tod Wolters ka folur lidhur me angazhimin e Shqipërisë në aleancë. "Baza Ajrore e Kuçovës do të jetë së shpejti një bazë e NATO-s. Shqipëria është një vend i sigurt, ku Aleanca do të investojë kapacitetet e saj. Investimi i NATO-s në Kuçovë është i rëndësishëm jo vetëm për sigurinë kombëtare por edhe atë rajonale. Brenda pak muajsh do jetë gati master-plani nga Agjencia e NATO-s për Prokurimet dhe Mbështetjen – NSP. Master-plani i hap rrugë fillimit të punimeve në terren. Demonstrimi që pamë sot tregon qartazi fuqinë e aleancën në shërbim të mbrojtjes kolektive. Vizita e gjeneralit dëshmon qartë vëmendjen. Shqipëria është angazhuar në një sërë nismash në NATO. Kjo është e vetmja rrugë që tregon se vlerat euroatlantike janë zgjidhja dhe zgjedhja e Ballkanit Perëndimor", tha Xhaçka.

Presidenti

Meta: Baza e Kuçovës, investim strategjik për sigurinë

Presidenti Ilir Meta, teksa pasi priti dje në një takim gjeneralin e NATO-s, e ka cilësuar përzgjedhjen e Kuçovës si vendndodhje të bazës moderne ajrore të organizatës një investim strategjik për sigurinë kombëtare dhe atë rajonale. "Baza ajrore e NATO-s në Kuçovë është një investim strategjik si për sigurinë tonë kombëtare, ashtu edhe për atë rajonale", theksoi Meta. Meta u shpreh më tej se Shqipëria është e interesuar që NATO të forcohet më tej si në aspektin politik ashtu edhe në atë ushtarak, e siguroi gjithashtu gatishmërinë për të plotësuar jo vetëm të gjitha detyrimet por edhe për të marrë përgjegjësi të reja. Presidenti i Republikës vuri në dukje se pas anëtarësimit të Malit të Zi, anëtarësimi i shumëpritur i Maqedonisë në NATO do të jetë një garanci e shtuar për sigurinë dhe stabilitetin rajonal. Në 10-vjetorin e anëtarësimit të Shqipërisë në NATO dhe 20 vite pas ndërhyrjes ushtarake të Aleancës, që i dha fund genocidit në Kosovë dhe rajon, Meta u shpreh se shqiptarët nuk do ta harrojnë kurrë kontributin e Shteteve të Bashkuara dhe NATO-s.

Shpallje Ankandi II

Shpallje Ankandi i Dyte: Lloji i prones: Arë me sip. 6000 m²; Vendi i ndodhjes: fshati Shtodher, Kavajë; ZVRPP Kavajë, Zona Kadastrale: 3427, Nr.pasurie 102/16, vol.6, fq.133; Në vlerën prej 94,080 (nëntëdhjetë e katër mijë e tetëdhjetë) EURO; Lloji i prones: Arë me sip. 6000 m²; Vendi i ndodhjes: fshati Shtodher, Kavajë; ZVRPP Kavajë, Zona Kadastrale: 3427, Nr.pasurie 102/18, vol.6, fq.135; Në vlerën prej 94,080 (nëntëdhjetë e katër mijë e tetëdhjetë) EURO; Lloji i prones: Arë me sip. 10605 m²; Vendi i ndodhjes: fshati Shtodher, Kavajë; ZVRPP Kavajë, Zona Kadastrale: 3427, Nr.pasurie 102/22, vol.6, fq.165; Në vlerën prej 553,913 (pesëqind e pesëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e trembëdhjetë) EURO; Lloji i prones: Arë me sip. 4995 m²; Vendi i ndodhjes: fshati Shtodher, Kavajë; ZVRPP Kavajë, Zona Kadastrale: 3427, Nr.pasurie 102/21, vol.6, fq.164; Në vlerën prej 593,600 (pesëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind) EURO. Vendi ku do të zhvillohet ankandi i shitjes së sendeve është salla e mbledhjeve e Shoqerise se Permbarimit "TDR GROUP" sh.p.k. e cila gjendet në adresën: BULEVARDI "GJERGJ FISHTA" KULLA NR. 5, KATI I 11-TË, NR.54 TIRANË. Ankandi II për shitjen e sendeve të paluajtshme shpallet sot dhe do të qëndroje i publikuar deri më datë 18.02.2019.

Qeveria vendos të “ngrijë” kontratat e HEC-eve që nuk janë operative

Pas protestës, “shpëton” Zagoria; kompania: S’do bëjmë kërkime nafte

Pas protestave të kohëve të fundit kundër shkatërrimit të burimeve natyrore në favor të bizneseve, konkretisht me projekte për ndërtimin e një HEC-i në Holtë të Gramshit dhe me kërkimet për naftë në zonën e mbrojtur të Zagorisë, duket se qeveria ka mbajtur qendrim të prerë në favor të kërkesave të komuniteteve lokale.

Në një dalje publike dje, ministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku, ka deklaruar se këto ditë janë shqyrtuar kontratat koncesionare të hidrocentraleve, të cilat janë 182 kontrata që u korrespondojnë 440 HEC-eve. Por sot vetëm 96 hidrocentrale janë operative, tha ajo, duke shtuar se kjo përbën një arsye për një vëzhgim të detajuar të të gjithë kontratave ende jo operative, në funksion të një sërë konkluzionesh të nevojshme për të gjykuar strategjinë e këtij sektori, efikasitetin e politikës së ndjekur në vite për stimulimin e HEC-eve të vegjël, impaktin ekonomik dhe social të tyre, e me radhë.

HEC-et

Këto ditë janë shqyrtuar kontratat koncesionare të hidrocentraleve, të cilat janë 182 kontrata që u korrespondojnë 440 HEC-eve. Por sot vetëm 96 hidrocentrale janë operative. Të tjerat do të pezullohen për skanim

“Kam vendosur fillimin e një procesi skanimi të dokumentacionit licensues të çdo subjekti të licensuar, e po ashtu dhe skanim fizik të çdo HEC-i dhe subjekti realizues. Procesi në fjalë do të bazohet në dy kritere, kriteri i përputhshmërisë ligjore dhe përmbushja e kushteve kontraktuale nga subjektet e licensuara, duke përfshirë këtu kushtet teknike dhe afatet kohore, si dhe kriteri i përputhshmërisë me kërkesat mjedisore. Ky institucion në pesë vitet e fundit ka bërë një disiplinim të madh të situatës së trashëguar, e cila ishte skandaloze, në kufijtë e kriminales, por jo vetëm e mira s’ka fund, edhe problemet e sektorit në këtë drejtim nuk janë sosur, por janë reale e shqetësuese. Prandaj ne, gjithashtu, do të skanojmë dhe vlerësojmë nëse kontratat ekzistuese janë në përputhje me kushtet mjedisore dhe standardet e kërkuara në zonat përkatëse. Kujtoj se koncesionarët kanë detyrim të jenë në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi përsa i përket mjedisit dhe kushteve mjedisore të vendosura në kontratë:, u shpreh ministrja.

Nga ana tjetër, ajo deklaroi se ka vendosur ngrirjen e të gjithë kontratave jooperative deri në daljen e raportit të skanimit të tyre. Po ashtu, tha Balluku, do të bashkërendojmë me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për një qasje ligjore dhe administrative të integruar në mënyrë që të mos përsëriten më situata ligjërisht të paatakueshme, por faktikisht të papranueshme, siç është dhe rasti i fundit në Gramsh. “Së bashku me ministrin Klosi do ta kthejmë rastin e Gramshit në një platformë diskutimi të hapur me komunitetin dhe do të punojmë për përmirësimin e bazës ligjore e të procedurave”.

Vërtet HEC-ët e vegjël kontribuojnë në ekonomi, por dhe mund të dëmtojnë ekonomikisht shumë më tepër sesa kontributi i tyre, nëse për një HEC të vogël i bie vlera një pasurie të madhe natyrore. Ndaj, na duhet një ekuilibër perfekt mes zhvillimit ekonomik dhe mbrojtjes se pasurive tona natyrore, të cilat janë pasuria më e madhe që ne shqiptarët kemi, vuri në dukje ministrja.

Rama

Në Tëitter kryeministri Edi Rama tha se “ne e kemi shpallur Parkun Kombëtar në programin e mbrojtjes së bukurive të natyrës nga HEC-e, gurore, etj. Si mund të lejojmë aty shpime naftëkërkuese! Nuk bën vaki”

NAFTA

Ndërkohë, pas protestës së banorëve të Zagorisë ndaj kërkimeve për naftë në Parkun Kombëtar dhe ftesës së kryeministrit Edi Rama për debat, ka reaguar së fundmi edhe drejtori i kompanisë Shell në Shqipëri, Rohan D’Souza. D’Souza është shprehur përmes një deklarate të shkurtër për mediat se, pavarësisht studimit të kryer nga kompania në bllokun 4, nuk do të kryejë kërkime në këtë zonë. Ai tha se në Parkun Kombëtar të Zagorisë nuk do të ketë asnjë aktivitet shpimi dhe kërkimi për naftë, pasi ajo është e kategorizuar si zonë e mbrojtur nga legjislacioni shqiptar.

Shell, një nga kompanitë më të mëdha globale në fushën e kërkimeve për naftën në datën 9 shkurt 2012, mori interesat e dy blloqeve ekzistuese kërkimi në tokë me vendndodhje në jug të Shqipërisë Qendrore (Blloqet 2-3) të mbajtura nga Petromanas. Në qershor të vitit 2013, Shell dhe Petromanas ranë dakord për një kalim të dytë interesash, i cili rezultoi në marrjen e 75% të interesave të Bllokut 2-3 nga Shell. Në shkurt të vitit 2016, Shell fitoi 25% të interesave të mbetura të Petromanas dhe u bë operator për Blloqet 2-3 në datën 1 mars 2016. Që në atë moment, ka shpuar pusin Shpirag 3 dhe në fillim të 2018-s nisi shpimin e një pusi të ri, pusin Shpirag 4.

Përpara këtij proponcimi nga ana e kompanisë, ka qenë vetë kryeministri Edi Rama, i cili ka deklaruar se “debati për kërkimet e naftës në Parkun Kombëtar të Zagorisë është i mirëseardhur për të kujtuar se: Ne e kemi shpallur Parkun Kombëtar në vazhdën e programit të mbrojtjes së bukurive të natyrës sonë nga HEC-e, gurore, etj. Si mund të lejojmë aty shpime naftëkërkuese! Nuk bën vaki”, shkroi Rama në Tëitter.

REAGIMET

Kërkime për naftë në Parkun e Zagorisë? Specialistët kundër

Zbulimi i naftës në zonën e Zagorisë dhe punimet nga Shell për evidentimin e këtyre rezervave ka shkaktuar debate të shumta. Banorët janë ngritur në protestë duke kundërshtuar shpimet, por edhe arkeologët i kanë cilësuar si gabim me pasoja të rënda kërkimet në Parkun e Zagorisë. Në një tryezë të organizuar dje në Tiranë nga Forumi për mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore në Tiranë, arkeologët Neritan Ceka dhe Apollon Baçe shprehin shqetësimin e tyre, për këtë iniciativë.

“Ne po humbasim me shpejtësi shumë të madhe, nuk është vetëm ndërhyrja që e shkatërron, por edhe indiferenca. Rast ka qenë kisha, sot ikën një tjegull, pasnesër një tjetër, derisa ikën e gjitha”, tha arkeologu Apollon Baçe.

“Në këtë rast kemi të bëjmë me një zonë që është park kombëtar ku ndërhyrja duhet që të jetë shumë e kujdesshme. Në këtë rast me një ndërhyrje brutale, siç është ajo e kërkimeve për naftën, qoftë edhe në fazën fillestare që kanë shpime edhe përdorim eksplozivash, të përjashtuar në mënyrë kategorike. Ka një potencial që është studiuar, por nuk bën pjesë në trajtimet që ka bërë qoftë qeveria edhe kompania, në dhënien e koncesionit. Ky aspekt është përjashtuar, që është një nga asetet më të mëdha të kësaj zone. Është ajo që quhet kultura postbizantine me kishat,q ë janë galeri të vërteta artesh, për të thënë edhe fakteve urave që njëra u shkatërrua pikërisht të mungesat të Ministrisë së Kulturës”, deklaroi Ceka.

Kjo zonë para një viti është shpallur Park Kombëtar me vendim të Këshillit të Ministrave. Për këtë çështje Rama u shpreh se debati është i mirëseardhur, por nuk ka asnjë leje për shpime në atë park. Ambientalistët edhe anëtarët e forumit gjatë ditëve në vazhdim do të mbajnë tubime, për parandalimin e nismave të tilla, që sipas tyre kanë në qendër shkatërrimin e pasurive tona arkeologjike dhe natyrore.

Bllokimi i mësimit, senati 'gozhdon' Mynyr Konin

Me kërkesë të studentëve të Universitetit të Tiranës, të cilëve nuk po iu mundësohet vazhdimi normal i mësimit, pasi një grup studentësh të forumeve politike të opozitës kanë uzurpuar auditorët e disa fakulteteve, është zhvilluar dje një takim mes Rektorit të Universitetit të Tiranës Mynyr Koni (i cili nuk ka ndërmarrë asnjë hap për lirimin e ambienteve siç kërkojnë studentët) dhe senatit akademik. Burimet bëjnë me dije se gjatë takimit, senati ka vënë me shpatulla pas murit rektorin Koni, duke i përplasur në sy faktin se është në shkelje flagrante të ligjit. Senati ka shkuar edhe më tej, ku duke mos toleruar shkeljen që po i bën ligjit Koni, ka kërkuar dorëheqjen e tij që t'i hapet rrugë vazhdimit normal të mësimit. Rektori Koni, theksojnë burimet, nuk ka patur asnjë mbështetje në senat, duke treguar kështu se tanimë senati i UT kërkon dorëheqjen e rektorit Koni. Kujtojmë se më herët studentët e fakulteteve, pas plotësimit të kërkesave të tyre nga qeveria, kanë kërkuar nga Koni me shkresë zyrtare por edhe me anë të prononcimeve në media, që të zhbllokojë ambientet e uzurpuara nga një grup personash politikë, pasi humbja e orëve të mësimit po çon në djegien e vitit akademik, që do të kishte një kosto shumë të lartë për familjet e të gjithë studentëve. Por, të gjitha kërkesat e studentëve kanë rënë në vesh të shurdhër, duke e bërë rektorin Koni pjesë të një plani ogurzi për djegien e vitit akademik për të gjithë studentët e UT-së. Ky rast i paprecedent mesa duket ka çuar edhe senatin në këtë kërkesë

ultimative për dorëheqjen e tij, pasi ata që e pësojnë nga heshtja dhe mos-zhbllokimi i fakulteteve, janë studentët.

KONI MOHON TË JETË KËRKUAR DORËHEQJA E TIJ

Në një reagim në rrjetet sociale, rektori i UT, Mynyr Koni mohon që në mbledhje të jetë kërkuar dorëheqja e tij. Në një postim në rrjetet sociale, Koni i quan spekulime të stisura lajmet për dorëheqjen e tij ndërsa nga ana tjetër pranon se studentët kanë kërkuar vazhdimin normal të procesit mësimor të pezulluar prej javësh të tëra nga një grup studentësh që kanë "kyçur" auditorët. "Sot në datën 24 janar 2019, në mbledhjen e Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës, ashtu sikurse ishte vendosur në rendin e ditës, u shqyrtua materiali i përgatitur nga grupi i punës në lidhje me aktet nënligjore të miratuara në datën 26 dhjetor 2018 nga Këshilli i Ministrave. Gjatë kësaj mbledhjeje, Dekani i Fakultetit të Drejtësisë Z. Artan Hoxha paraqiti situatën mbi atë se çfarë po ndodh në këtë fakultet dhe pas diskutimeve, Senati vendosi të dëgjojë një përfaqësi të studentëve të FD rreth shqetësimeve të tyre për vijueshmërinë e procesit mësimor. Studentët kërkuan që t'u garantohet e drejta për procesin e mësimdhënies. Në këto kushte, Rektori i Universitetit të Tiranës deklaroi menjëherë se ditën e premte datë 25 janar 2019, ora 10:00, do të shkojë në Fakultetin e Drejtësisë për të takuar studentët që ndodhen brenda këtij fakulteti. Më pas Senati vazhdoi mbledhjen e tij sipas axhendës. Çdo artikulim tjetër nga disa portale lajmesh është i pavërtetë dhe një spekulim i stisur", ka thënë Koni.

PD lekë për protestuesit, Basha: Të paguhen shpenzimet

Mister burimi i financimit, Basha u kërkon degëve të gjejnë problemet dhe arsyet se pse duhet protestuar

Partia Demokratike do të paguajë para për pjesëmarrësit në protestën e 16 shkurtit. Kryedemokrati Lulzim Basha, në udhëzimin e tij për organizimin e protestës së madhe kërkon nga të gjitha strukturat përgatitjen e logjistikës për transportin falas dhe shpenzimet për të gjithë pjesëmarrësit në ditën e protestës së madhe. Në udhëzimin e kryetarit të Partisë Demokratike saktësohet mbulimi i shpenzimeve të protestës. "Të bëhet përgatitja e logjistikës për transportin dhe shpenzimet e protestës caktimi i vendit nisjes nga dega, propozimi i vendit dhe orës takimit të degës pranë kryeministrisë", thuhet në udhëzimin e Bashës. Kostoja për një pjesëmarrës në protestën e opozitës së 16 shkurtit, duke llogaritur udhëtimin dhe një ushqim minimal, është rreth 10 dollarë. Deri më tani financuesi i protestës së PD mbetet mister. Nuk dihet nëse pas protestës, PD do të bëjë transparente për mediat shpenzimet e këtij tubimi dhe se kush janë financuesit. Në raportet vjetore financiare që PD ka dorëzuar në KQZ, nuk ka deklaruar asnjë shpenzim për asnjë nga protestat që ka organizuar si dhe as për ngujimin në çadrën para Kryeministrisë në pranverën e 2017.

Misteri
Deri më tani financuesi i protestës së PD mbetet mister. Nuk dihet nëse pas protestës, PD do të bëjë transparente për mediat shpenzimet e këtij tubimi dhe se kush janë financuesit

BASHA NUK DI ARSYET E PROTESTËS

Në udhëzimin e tij për organizimin e protestës, Lulzim Basha u kërkon degëve të partive që të gjejnë problematikat për ta cilat duhet protestuar në rrethe, në funksion të protestës së 16 shkurtit. "Kryesia e degës dhe të deleguarit diskutojnë organizimin e protestave lokale që do të organizohen nga dega në rrethe ku të identifikohet problematika lokale për të cilën duhet të protestohet, si dhe duke sugjeruar tematikën, formën, gatishmërinë për periudhën e mundshme kur mund të zhvillohet midis datave 2-12 shkurt", thuhet në udhëzimin e Bashës.

DETYRA PËR DEPUTETËT

Kryetari i Partisë Demokratike Lulzim Basha ka urdhëruar gjithashtu deputetët, kryetarët e degëve dhe të gjithë të deleguarit në rrethe, të organizojnë të gjitha strukturat për protestën e madhe që do të organizohet më 16 Shkurt në kryeqytet. Në udhëzimin e firmosur nga kreu i PD-së, kërkohet që mes datave 2 dhe 12 shkurt të organizohen protesta lokale në të gjitha rrethet, duke shkruar më derë të qytetarëve. "Organizimi i punës për takimet derë më derë në nivel seksioni dhe grupseksioni dhe format e përshtatshme për të ftuar dhe siguruar pjesëmarrjen e anëtarëve dhe qytetarëve në protestën e madhe në Tiranë, apo në protestat lokale", thuhet në udhëzim. Po ashtu në udhëzim thuhet se duhet të përcillet mesazhi tek qytetarët për sigurimin e pjesëmarrjes maksimale me të gjitha format, takime me strukturat, takime me qytetarët derë më derë, ture, fletushka, njoftime në rrjetet sociale, njoftime me sms apo dhe telefonata. Ditën e sotme Basha do të mbledhë grupin parlamentar për të diskutuar se në cilat komisione do të marrin pjesë për të ngritur zërin, kundër politikave të qeverisë dhe për të ndihmuar në përcjelljen e mesazhit tek qytetarët.



Nr. Prot. 5
Dt. 23/01/2019

PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË
KRYETARI

Partia Demokratike e Shqipërisë

UDHËZIM

"Mbi zbatimin e vendimit të datës 22/01/2019 të Kryesisë së PDSH për zhvillimin e protestave lokale dhe protestës së datës 16 Shkurt 2019".

1. Kryetari i Degës dhe të deleguarit e Kryesisë së PDSH-së, janë përgjegjës për organizimin dhe moblizimin e qytetarëve dhe anëtarëve të partisë, për pjesëmarrjen e tyre në protestat lokale dhe Protestën e Madhe të datës 16 Shkurt, ora 11.00, në Tiranë.

2. Të Deleguarit e Kryesisë për secilin Qark janë sipas listës në Aneksin 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi. Ndarja e anëtarëve të grupit të të Deleguarve në Qark, sipas degëve në përbërjen e Qarkut, përcaktohet me konsensus mes Kryetarëve të Partive dhe anëtarëve të grupit të të Deleguarve, ku përcaktohet edhe zona përkatëse e tyre.

3. Për marrjen e masave lidhur me protestën dhe për çështje të tjera statutore, të Deleguarit e Kryesisë së PDSH-së dhe Kryetari i Degës, koordinojnë për organizimin e mbledhjes së Kryesisë së Degës. **Mbledhja e Kryesisë së Degës, të zhvillohet brenda datës 25 Janar 2019.** Kryetari i Degës njofton të Deleguarin për orën dhe datën e mbledhjes së Kryesisë.

4. Mbledhjet e Kryesive do të organizohen, ne rrafshin politik (detyrimet statutore) dhe aksionit qytetar (protesta), sipas **rendit të ditës** më poshtë:

A. LIDHUR ME DETYRIMET STATUTORE:

Njohja dhe marrja e masave për zbatimin e vendimeve të Kryesisë së PDSH për Degët:

i. Vendimit nr. 1, datë 22.01.2019
ii. Vendimit nr. 2, datë 22.01.2019
iii. Marrjen e masave organizative për identifikimin [illegible]
përfshihen në Shtabet Elektorale, menjëherë pasi Kryesia e
miratoi Udhëzimin përkatës brenda kësaj jave.

B. LIDHUR ME AKSIONIN QYTETAR

Kryesia e Degës dhe të deleguarit, diskutojnë:

i. **Organizimin e protestave lokale** që do të organizohen nga Degët në rrethe, ku të identifikohet problematika lokale për të cilën duhet të protestohet, si dhe duke sugjeruar tematikën, formën, gadishmërinë për periudhën e mundshme kur mund të zhvillohet **midis datave 2-12 Shkurt 2019**, si dhe vendin. Nën kujdesin e të Deleguarit, disa Degë brenda Qarkut mund të organizojnë protesta të përbashkëta, ku Degët mbështesin njëra tjetrën. Në cdo rast, me kërkesë të të deleguarit, një Degë brenda Qarkut, mbështet protestën e Degës tjetër brenda Qarkut. Degët e Tiranës do të koordinohen së bashku për protestat lokale në Tiranë, për të njëjtën periudhë 2-12 Shkurt 2019.

ii. **Përgatitja për pjesëmarrje në Protestën e madhe më 16 Shkurt 2019, ora 11:00**, në Tiranë përpara Kryeministrisë.
ii.1.Organizimi i punës për takimet derë më derë në nivel seksioni dhe grupseksioni, dhe format e përshtatshme për të ftuar dhe siguruar pjesëmarrjen e anëtarëve dhe qytetarëve të tjerë në Protestën e Madhe në Tiranë, apo në protestat lokale.
ii.2.Parashikimi i pjesëmarrjes në nivel grupseksioni dhe në nivel Dege, si dhe të merren masa për evidentimin e pjesëmarrjes me qëllim vlerësimin e kontributeve.
ii.3. Përcjellja e mesazhit te qytetarët për sigurimin e pjesëmarrjes maksimale me të gjitha format, takime me strukturat, takime me qytetarët derë më derë, ture të Kryetarit, fletushka, njoftime në rrjetet sociale, njoftimit me sms apo telefonata, etj;
ii.4. Përgatitja e logjistikës për transportin dhe shpenzimet në ditën e protestës; caktimi i vendit të nisjes nga Dega; propozimi i vendin dhe orës së takimit të degës pranë Kryeministrisë.
ii.5.Caktimi i datës, orës dhe vendit të mbledhjes së Aktivit të Degës.
ii.6.Ndarja e të Deleguarve dhe anëtarëve të Kryesisë së Degës në zonë.

PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË, Bulevardi Zhan D'Ark, Nr 11, Tiranë

shqiptarja.com

PROJEKTLIGJI

Biznesi i vogël me TVSH e OJF-të detyrim për të hapur llogari bankare

Duhet t'i hapin brenda tre muajve, parashikohen gjoba 100-200 mijë lekë

Qeveria vendos detyrim ligjor për subjektet e biznesit të vogël, të cilët kanë kaluar tashmë në skemën e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), por edhe për Organizatat Jo-Fitimprurëse, që të hapin llogari bankare në emrat e tyre. Përndryshe do të marrin gjoba.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka përgatitur një projektligj, që nuk ka kaluar ende në shqyrtimin e Këshillit të Ministrave, pikërisht për të vendosur një rregull të ri edhe në këtë fushë. Ai parashikon të bëjë shtesën përkatëse në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

NDRYSHIMI

Sipas ministrisë, në këtë ligj duhet përfshirë edhe kjo klauzolë: Tatimpaguesit me status "person fizik tregtar" të regjistruar për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, tatimpaguesit me status "person juridik", pavarësisht nga qarkullimi që realizojnë, si dhe organizatat jofitimprurëse të regjistruara në organin tatimor, janë të detyruar të kenë llogari bankare të biznesit/organizatës të regjistruar.

Ndërkohë parashikohet që mos të jenë subjekte të këtij detyrimi, tatimpaguesit, persona fizikë tregtar të cilët realizojnë qarkullim vjetor, rrjedhimisht edhe qarkullim të parasë fizike, në vlera të ulta. Për këtë arsye, është marrë për referencë, kufiri i regjistrimit për përgjegjësinë tatimore: Tatimi mbi Vlerën e Shtuar.

SANKSIONET

Në mungesë të zbatimit të kësaj kërkese ligjore, parashikohen sanksione të caktuara. Subjektet që do ta kenë këtë detyrim, në rastin kur nuk disponojnë llogari bankare për transaksionet që kryejnë, dënohen si më poshtë.

Tatimpaguesit me status "person fizik tregtar", të regjistruar për tatimin mbi vlerën e shtuar,me qarkullim deri në 8 milionë lekë, gjobënë masën 50 mijë lekë; tatimpaguesit me status "person juridik" pavarësisht nga qarkullimi, si dhe tatimpaguesit mestatus "person fizik tregtar" me qarkullim mbi 8 milionë lekë, gjobë në masën 100 mijë lekë.

Ndërsa organizatat jofitimprurëse, gjobë në masën 75 mijë lekë.

Sipas ndryshimeve të planifikuara, në rast se subjekti nuk ka llogari bankare për transaksionet që kryen edhe pas denimit si më sipër, ai do të dënohet me dyfishin e gjobës së parë.

Subjektet e regjistruara rishtaz, duhet të hapin llogarinë bankare jo më vonë se 20 ditë kalendarike pas regjistrimit ne QKB/administratën tatimore. Kurse subjektet që janë të regjistruara në QKB/administratën tatimore, duhet te hapin llogarinë bankare jo më vonë se 90 ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

ARSYETIMI

Në argumentimin e ministrisë, thuhet se ky projektligj ka si qëllim adresimin e një prej rekomandimeve të Komitetit të Ekspertëve për vlerësimin e masave kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (Moneyval), të Këshillit të Evropës, lidhur me përdorimin e parasë fizike dhe reduktimin e ekonomisë informale. Në kuadër të procesit të vlerësimit nga Komiteti Moneyval i Këshillit të Evropës, me publikimin e Raportit të vlerësimit, Shqipërisë i është lënë një vit kohë për përmbushjen e Rekomandimeve dhe adresimin e problematikave të evidentuara në Raport. Raporti synon vlerësimin e përputhshmërisë të kuadrit ligjor e rregullativ në vend, për çështjet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, me 40 Rekomandimet e FATF, të cilat njihen si standart detyrues e unifikues në rang botëror për këto çështje. Në datën 4 shtator 2018, Komiteti për Bashkërendimin e Luftës Kundër Pastrimit të Parave (KBLKPP), nën drejtimin e Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, ka miratuar planin e veprimit, duke caktuar për çdo masë afate dhe institucione përgjegjëse.

Një ndër masat e parashikuara në kuadër të këtij plani, lidhet me reduktimin e ekonomisë informale dhe përdorimit të parasë fizike nga personat fizikë/juridikë tregtarë. Për këtë qëllim, duke adresuar njëkohësisht rekomandimet e Komitetit Moneyval, propozohet të sanksionohet në ligjin për procedurat tatimore, detyrimi i të gjithë tatimpaguesëve persona fizikë/juridikë, përfshirë edhe organizatat jofitimprurëse për të pasur llogari bankare biznesi.

Gjobat e parashikuara për rastin kur subjektet nuk hapin llogari

Tatimpaguesit me status "person fizik tregtar", të regjistruar për tatimin mbi vlerën e shtuar, me qarkullim deri në 8 milionë lekë

50 mijë lekë

Tatimpaguesit me status "person juridik" pavarësisht nga qarkullimi, si dhe tatimpaguesit me status "person fizik tregtar" me qarkullim mbi 8 milionë lekë

100 mijë lekë

Organizatat jofitimprurëse

75 mijë lekë

Në rast se subjekti nuk ka llogari bankare për transaksionet që kryen edhe pas denimit si më sipër, ai do të dënohet me dyfishin e gjobës së parë

Detyrimi

Subjektet e regjistruara rishtaz, duhet të hapin llogarinë bankare jo më vonë se 20 ditë kalendarike pas regjistrimit ne QKB/administratën tatimore. Kurse subjektet që janë të regjistruara në QKB/administratën tatimore, duhet te hapin llogarinë bankare jo më vonë se 90 ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji



TEKNOLOGJIA

Nëpërmjet portalit e-Albania janë dhënë më shumë se 600 mijë vërtetime

626.956 vërtetime janë dhënë përmes portalit e-Albania nga Administrata Tatimore, për periudhën janar – dhjetor 2018 për individët, subjektet e interesuara, si edhe direkt nga punonjësit e institucioneve të përfshira në këtë portal. Pjesa më e madhe janë vërtetime për pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të marra nga individë apo subjekte, por edhe për pagim detyrimesh etj.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve bën të ditur se, gjatë vitit 2018, ka ofruar një sërë shërbimesh për tatimpaguesit, individët dhe institucionet publike, si në rrugë elektronik, ashtu edhe në sportele, pa asnjë kosto dhe në çdo kohë. Ofrimi i shumë shërbimeve në rrugë elektronike ka bërë që të reduktohen ndjeshëm kontaktet e drejtëpërdrejta me administratën, radhët e gjata dhe koha e pritjes. Për vitin 2018 janë dhënë 41.153 vërtetime në sportelet e Zyrave të Shërbimit të Tatimpaguesve, në një kohë që për vitin 2017 janë dhënë rreth 250.000 vërtetime në spotele.

Cyan magenta yellow black

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

SHPALLJE E VENDEVE VAKANTE

Kolegji i Posaçëm i Apelimit (KPA) pranë Gjykatës Kushtetuese, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit", i ndryshuar me vendimin nr.101 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 *Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit":*

- **Rishpall 1 (një) vend vakant për pozicionin "Këshilltar Ligjor" me afat sa mandati i gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit në Njësinë e Shërbimit Ligjor.**
- **Rishpall 1 (një) vend vakant për "Këshilltar Ligjor" me afat jo më pak se 6 (gjashtë) muaj dhe jo më shumë se 1 (një) vit në Njësinë e Shërbimit Ligjor.**
- **Rishpall 1 (një) vend vakant për pozicionin "Drejtor" në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse.**
- **Shpall 1 (një) vend vakant për pozicionin "Specialist për Pritjen me Popullin" në Drejtorinë e Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun.**

KËRKESAT E POSAÇME TË POZICIONIT "KËSHILLTAR LIGJOR" NË NJËSINË E SHËRBIMIT LIGJOR:

a. Të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë "Master i shkencave" në Shqipëri ose studimet universitare për drejtësi jashtë vendit dhe ka marrë një diplomë të njësuar sipas rregullave për njësimin e diplomave, të parashikuar me ligj;
b. Të ketë një përvojë pune në sistemin e drejtësisë ose administratën publike jo më pak se 7 vjet;
c. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi, si dhe për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje, ose ndaj tij të mos ketë nisur një hetim penal;
d. Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit;
e. Të zotërojë shumë mirë gjuhën angleze.

KËRKESAT E POSAÇME TË POZICIONIT "DREJTOR" NË DREJTORINË EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE :

a. Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" për Ekonomi.
b. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
c. Të ketë të paktën 5 vite përvojë pune në nivel drejtues e menaxherial.

KËRKESAT E POSAÇME TË POZICIONIT "SPECIALIST PËR PRITJEN ME POPULLIN" NË DREJTORINË E MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME MEDIAN DHE PUBLIKUN:

a. Të zotërojë diplomë të arsimit të Lartë, në Drejtësi.
b. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
c. Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion.

KUSHTE TË PËRGJITHSHME:

- Kandidatët duhet të sigurohen se plotësojnë kriteret për t'u pajisur me Certifikate Sigurie, sipas Vendimit Këshillit Ministrave nr.188, datë 4.3.2015.
- Kandidatët duhet të kenë aftësi për t'u përshtatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afate kohore të limituara.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së Kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të KPA-së, në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Nr. 3, Tiranë, nga e hëna në të premte, ora: 09:00-16:00.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë institucionit të KPA-së në adresën: "Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Nr. 3, Tiranë.

  - Aplikimi në rrugë postare **për pozicionin "Këshilltar Ligjor"** duhet të kryhet brenda datës **7 shkurt 2019**, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatin e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

  Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data **24 janar 2019 deri 7 shkurt 2019** në adresën info@kpa.al. KPA konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

  - Aplikimi në rrugë postare **për pozicionet "Drejtor" në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe p**ër pozicionin **"Specialist për Pritjen me Popullin" në Drejtorinë e Menaxhimit të** Çështjeve **dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun** duhet të kryhet brenda datës **2 shkurt 2019**, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatin e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

  Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data **24 janar 2019 deri 2 shkurt 2019** në adresën info@kpa.al. KPA konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

1. Jetëshkrim profesional në gjuhën shqipe, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
2. Kopje të dokumentave (diplomë, letërnjoftimi (ID), librezë pune) original ose të noterizuar. Diplomat qe janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;
3. Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal;
4. Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
5. Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore ne fuqi;
6. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
7. Cdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnime, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Kandidatët të cilët aplikojnë nëpërmjet postës elektronike, nëse do të vlerësohen që plotësojnë kriteret ligjore, duhet të paraqesin ditën e intervistës dokumentet origjinale ose të njehsuara me origjinalin, që vërtetojnë kushtet e parashikuara sipas pikave 1-7.

Nis rekrutimi në Akademinë e Policisë, ja kriteret

Ministria e Brendshme ka njoftuar se fillimin e procedurave për rekrutimin e studentëve. Si bëhet përzgjedhja e kandidatëve

Në datën 1 shkurt, Policia e Shtetit do të nisë procedurat për rekrutimin e 100 studentëve që kanë përfunduar universitetin. Kjo hapje e policisë për studentët me rezultate të mira ishte paralajmëruar nga Ministri I Brendshëm Sandër Lleshaj, por tashmë është zyrtarizuar. "Shqiptarja.com" zbardh sot kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për t'u pranuar në Akademinë e Policisë.

Ndër kriteret kryesore të përzgjedhjes dhe pranimit të kandidatëve janë: mesatarja e notave mbi 8; nivel i mirë i gjuhës angleze, që do të verifikohet me provim si dhe kondicioni trupor dhe fizik i përshtatshëm. Pranimi do të bëhet nga degët jurisprudencë, ekonomi, financë, informatikë dhe elektronikë. Kandidatët duhet të kenë përfunduar studimet në nivelin master.

KRITERET
mesatarja e notave mbi 8
nivel i mirë i gjuhës angleze, me provim
kondicion trupor dhe fizik i përshtatshëm
DEGËT
JURISPRUDENCË
EKONOMI
FINANCË
INFORMATIKË
ELEKTRONIKË

Sipas njoftimit të Ministrisë së Brendshme rekrutimet e reja synojnë të përmirësojnë nivelin professional të strukturave të policisë. "Kjo hapje e Policisë për të marrë studentë të ekselencës bëhet pas ndryshimeve në ligjin për Policinë e Shtetit. Hapja synon afrimin e kapaciteteve profesionale për strukturat e hetimit të policisë kriminale", thuhet në njoftim.

Aktualisht Ministria e Brendshme ka dhënë kriteret kryesore të aplikimit, por që do të detajohen më vonë si dhe do të përcaktohen procedurat e konkursit. "Në njoftimet e ardhshme, do të detajohen procedurat e aplikimit dhe të konkursit. Ftohen të gjithë studentët që kanë kryer ciklin e studimeve që përmbushin kriteret, të marrin pjesë në garën për t'u bërë pjesë e Policisë së Shtetit", sqarohet në njoftimin e Ministrisë së Brendshme.

ZGJEDHJET VENDORE

Balla: Qazim Sejdini nuk do rikandidojë në Elbasan

Qazim Sejdini do tërhiqet nga Bashkia e Elbasanit pas 12 vitesh drejtimi. Ai nuk do e rikandidoje ne zgjedhjet lokale. Këtë e deklaroi kryetari i grupit parlamentar socialist Taulant Balla në emisionin "Open". I pyetur për kandidatët që do të marrin pjesë në zgjedhjet lokale të 30 qershorit, Balla është shprehur se Sejdini është tërhequr për arsye personale. "Qazim Sejdini ka vendosur që të mos jetë më kandidatë në krye të Bashkisë së Elbasanit. Është një vendim i tij", tha Balla. Qazim Sejdini drejton Bashkinë e Elbasanit prej vitit 2007 kur ai fitoi për herë të parë përballë Luçiano Boçi dhe më pas ka mundur me radhë të gjithë rivalët.

Cyan magenta yellow black

Klinikat dentare dyfishojnë çmimet, MSH: Vendimi i pa aplikueshëm

Urdhrit të Stomatologut ka vendosur një listë të re me çmimet e dentistëve. Ministria kundërshton: S'është tagër i Urdhrit

Klesiana Omeri
TIRANE

Prej fillimit të 2019-s, klinikat dentare në vend mësohet se po aplikojnë një listë të re me çmimet dysheme për shërbimet bazë që ofrojnë, duke i rritur tarifat me 100%. Për një mbushje dhëmbi të gradës së dytë, përpara 1 janarit, pacientët në klinikën e tij duhet të paguanin 2,000 lekë, ndërsa tani me çmimin dysheme që ka vendosur Urdhri i Stomatologut, pacientët duhet të paguajnë 4,000 lekë, ose dyfish. Rritje ka pasur edhe për shërbimet e tjera dentare. Pjesa më e madhe e klinikave në vend për vizitat e pacientët (ekzaminim me sy) i kanë falas, por prej 1 janarit për vizitat çmimi dysheme është 500 lekë. Për mbushjet e gradës së tretë, çmimi ishte 3,000 lekë, ndërsa me referencën e re çmimi bëhet 5.000 lekë (2.000 lekë më shumë, shtrenjtim 67%). Çmimi për pastrimin e gurëzave dhe të cipave bëhet 3.000 lekë, nga 1.500 lekë, sa dyfishi. Heqja e dhëmbëve bëhet 1.000 lekë nga 500 që ishte. Pas kësaj situate ka reaguar Drejtori i Urdhrit të Stomatologëve Nikoll Deda. Për Report Tv ai thotë se kjo listë çmimesh ka karakter sensibilizues dhe nuk është e detyrueshme për dentistët. Sipas tij, "kjo vendosje e çmimeve është kërkuar nga vetë dentistria". "S'ka asnjë qindarkë rritje çmimesh. Ato janë çmime dysheme, çmime orientuese, nuk kanë asnjë fuqi detyruese për dentistët, por janë për qytetarin. Çdo

dentist është i lirë të punojë me çmimet që dëshiron", tha Nikoll Deda, President i Urdhrit të Stomatologëve. Por pikërisht kjo deklaratë e bën të paqartë situatën dhe vendos në pozita të vështira klinikat dentare. Në listën e publikuar nga Urdhri i Stomatologëve që mban vulën dhe firmën e presidentit të këtij institucioni thuhet se kjo listë çmimesh është dysheme çka nuk lejon çmime të tjera poshtë çmimeve të publikuar në këtë listë. Po në këtë dokument thuhet se: "Për shërbimet e tjetra të papërfshira në listë dentistët janë të lirë të vendosin vetë çmimet", duke vendosur kufizime për dentistët dhe duke detyruar këta të fundit të rrisin çmimet e shërbimeve që ofrojnë. Por edhe pse Presidenti i Urdhrit të Stomatologëve thotë se klinikat dentare nuk janë të detyruar të aplikojnë këto çmime, për Report Tv dentistët shprehen se ka filluar rritje e çmimeve, madje janë skeptikë nëse qytetarët do jenë dakord ose jo. "Këtë njoftim ne e kemi parë në faqen e Urdhrit të Stomatologëve. Është thënë që kjo listë në janar do i ndërtohet Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë. Ne momentalisht e kemi aplikuar këtë listë, i kemi rritur pak çmimet, potr jo në ato nivele që ka parashikuar Urdhri, po e testojmë me qytetarët. Për zonat periferike apo zonat pak më në rrethe mund të jetë pak e vështirë për shkak të nivelit social. Mund të jetë pak e vështirë si për mjekët ashtu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
URDHRI I STOMATOLOGUT
ASAMBLEJA KOMBËTARE

Lista e çmimeve dysheme për shërbimet në klinikat dentare
Miratuar nga Asambleja Kombëtare
dhe Këshilli Kombëtar

Vizita – 500 L
-Terapi-
Mbushje grada e II-të – 4.000L
Mbushje grada e III-të – 5.000L
Pastrim gurëzash – 3.000L
-Ortopedi-
Protezë klasike (komplet) – 40.000L
Protezë parciale(e thjeshtë) – 15.000L
Protezë e lëvizshme e skeletuar – 35.000L
Këllëf porcelani – 9.000L
Zirkon – 18.000L
-Kirurgji-
Ekstraksion – 1.000L
Implant – 70.000L
-Ortodonci-
Aparat i lëvizshëm i thjeshtë – 30.000l
Aparat fiks – 100.000L
Për të gjitha punimet ortopedike, dentisti duhet të marrë nga laburanti dy fletëgaranci 5(pesë) vjeçare:
a. Një fletëgaranci i jepet pacientit;
b. Një fletëgaranci e mban dentisti në protokollin e mjekimit.

Për shërbimet e tjera të papërfshira në listë dentistët janë të lirë të vendosin vetë çmimet

Lista e çmimeve do t'i bëhet e ditur Ministrisë së Financave të implementohet në kasat fiskale

Presidenti i USSH
Dr. Nikoll Deda

dhe për pacientët të adaptohen me këto çmime", shprehet një stomatolog. Ky vendim i Urdhrit të Stomatologut, i miratuar dhe nga Asambleja Kombëtare dhe Këshilli Kombëtar, detyron klinikat dentare të rrisin çmimet për shërbimet që ofrojnë. Ndërkohë, kundër këtij vendimi ka dalë Ministria e Shëndetësisë. Përmes një deklarate të shpërndarë për mediat theksohet se Ministria Shëndetësisë është shprehur kundër vendimit të urdhrit të stomatologëve për tarifat dysheme për shërbimet dentare. MSH thekson gjithashtu se nuk është tagër i Urdhrit të Stomatologut caktimi i çmimeve për shërbimet dentare. "Vendimi i Urdhrit të Stomatologut është i paaplikueshëm sepse nuk është tagër i Urdhrit. Që kur është bërë mbledhja përfaqësuesit tanë kanë votuar kundër. Ky vendim nuk është i aplikueshëm", deklaron Ministria e Shëndetësisë

Lidhur me këtë çështje ka reaguar dhe deputeti i PD-së Tritan Shehu i cili e quan një dështim të politikave sociale të Rilindjes. Deputeti Shehu ka kërkuar ndërhyrjen e shtetit, për të krjuar mbulesat financiare për qytetarët dhe stomatologjinë. Ndërsa nënkryetari i Komisionit të Shëndetësisë dhe njëherazi deputeti i PD, Bardh Spahia ka akuzuar qeverinë se është përfshirë në këtë vendim "të paligjshëm" dhe "korruptiv" me heshtjen e saj. Ai akuzoi konkretisht Ministrinë e Financave dhe atë të Shëndetësisë.

Gjykata le në burg grabitësin e banesës së Elton Çiços

Burg pa afat për Erigers Mihasin, mik me Ervis Martinajn, u zbulua gjatë hetimeve për masakrën te Blloku

Prova që mbante Erigers Mihasin pas hekurave, ishin shenjat e tij të gishtërinjve në automjetin që u përdor për grabitjen e shtëpisë së Çiços. Ai u zbulua gjatë hetimeve për përplasjen me armë në ish-bllok, pasi njihej si mik me Ervis Martinajn dhe është shoqëruar për t'u marrë në pyetje. Dje Gjykata e Gjirokastrës vendosi masën e arrestit burg pa afat për Mihasin. Elton Çiço u vra në prill 2016 në Tiranë. Gjykata e Shkallës së Parë në Gjirokastër, ka lënë në burg pa afat Erigers Mihasin, i dyshuar për grabitjen e banesës së Elton Çiços katër vjet më parë në qytetin e Tepelenës. Seanca, e cila filloi në orën 14:30 të ditës së sotme, ka zgjatur 10 minuta ndërkohë që paraprakisht ishin marrë masa nga policia e Gjirokastrës për të ruajtur ambientet brenda dhe jashtë godinës së Gjykatës për të parandaluar ndonjë situatë të pakëndshme. Vetë Mihasi kishte kërkuar avokat nga kryeqyteti për t'u mbrojtur por në mungesë të tij, iu vendos një avokat nga shteti. Kryesuesi i seancës Pëllumb Vehbi në fillim i dha fjalën akuzës përmes Emror Kasaj prokurorit të çështjes i cili vlerësoi se arrestimi i Mihasit nga policia e Gjirokastrës ishte i ligjshëm dhe kërkoi nga kryesuesi i seancës që të jepte masën "burg pa afat". Deri më tani prova e vetme që mban Mihasin pas hekurave, janë shenjat e tij të gishtërinjve në automjetin që u përdor për grabitjen me armë të banesës së Elton Çiços në shtator të 2015. Ndërkohë që Elton Çico u vra një vit më vonë në kryeqytet në një atentat të organizuar nga Jani Aliaj. Vetë i dyshuari si pjesmarrës në grabitje Erigers Mihasi, ka mohuar akuzën ndaj tij dhe kundërshtuar prokurorin Emror Kasaj. Më pas kryesuesi i seancës, ka dhënë masën "burg pa afat" për Mihasin. Gjurma e gishtit që e lidh Mihasin në këtë grabitje të shëmtuar të dy të moshuarve, është zbuluar në vazhdën e hetimeve që prokuroria dhe policia e Tiranës, po kryenin

Elton Çiço

Erigers Mihasi

për masakrën e 4 tetorit 2018 të ndodhur në lokal "Monopol" në ish-bllok, ku u përplasën me armë dy grupe kriminale të Tiranës. Për policinë kriminale, Mihasi konsiderohet si mik i Ervis Martinaj që tashmë ndodhet në paraburgimin 302 në Tiranë. "Shqiptarja.com" mëson se pas masakrës në lokal, policia shoqëroi dhe pyeti disa persona që njihen, si lidhje e afërt me Ervis Martinaj. Një ndër këta persona është dhe Erigers Mihasi,të cilit pasi i është marë deklarimi në polici, oficerët i kanë marë dhe shënjat e gishtave me qëllim krahasimin e tyre me gjurmët e gishtave që kishin fiksuar ekspertët brenda lokalit "Monopol", ku ndodhi masakra në të cilin dy persona mbetën të plagosur dhe Fabiol Gaxha mbeti i vrarë.

Akuzat për korrupsion

Pezullim nga detyra dhe detyrim paraqitje për prokurorin Çoçoli

Gjykata e Krimeve të Rënda ka dhënë dje masën e sigurisë për prokurorin e Gjirokastrës, Spartak Çoçoli i dyshuar si i përfshirë në një aferë korrupsioni dhe dy persona të tjerë. Me kërkesë të Prokurorisë, Gjykata ka vendosur pezullim nga detyra dhe detyrim paraqitje për prokurorin, ndërsa për dy të tjerët, Ervin Hysaj dhe Ernest Duro, ka dhënë masën e arrestit me burg. Të tre akuzohen për veprën penale të korrupsionit pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funkionarëve të tjerë të drejtësisë. Prokurori Çoçoli u shoqërua në polici 10 ditë më parë pas një hetimi ndaj tij për korrupsion. Emri i prokurorit Spartak Çoçoli nuk është i panjohur për publikun. Prokurori akuzohej nga një qytetar në Gjirokastër se i kishte marrë 1 mijë euro për çështjen e vajzës 17-vjeçare të komunitetit rom e cila ishte rrëmbyer nga një 40-vjeçar, mirëpo titullari i organit të akuzës nuk e kishte lënë në burg autorin

Fadil Kepi: Pensionet familiare, kush i përfiton dhe si llogariten

Eksperti sqaron se çfarë janë pensionet familiare, dokumentet që duhen dhe raste specifike të përfitimit

Në emisionin e mirënjohur "Këndi i Ekspertit" në Report Tv, të drejtuar nga gazetarja Valbona Mhilli, ka qenë i ftuar eksperti i problematikave të pensioneve, Prof. Dr. Fadil Kepi. Në puntatën e kësaj jave Profesor Kepi ka sqaruar qytetarët për çështjen e pensioneve familjare. Eksperti ynë ka sqaruar se çfarë janë pensionet familjare, dokumentet që duhen për ta përfituar dhe raste specifike të përfitimit, duke dhënë disa shembuj. Më pas Profesor Kepi u është përgjigjur live pyetjeve që kanë mbërritur nga qytetarët në Report TV.

Sot do të diskutojmë për pensionet familjare. Çfarë janë pensionet familjare? Kush i përfiton ato? Si llogariten pensionet familjare dhe cilat janë dokumentet që duhen plotësuar për të përfituar pensionin familjar?

Pension familjar do të thotë pensioni që i jepet pjesëtarëve të familjes, të cilët janë në ngarkim të personit që ndërron jetë. Në vendin tonë, nga 660 mijë pensionistë, vendin e dytë me 70 mijë e zënë pensionet familjare. Siç e thamë, në vendin tonë mesatarisht vdesin në ditë 62 persona, lindin 85 fëmijë dhe dalin në pension 100 persona. Ata që vdesin lënë trashëgimtarë pa pension ose lënë edhe fëmijë, të cilët mund të jenë të mitur, në shkollë 9-vjeçare, në shkollë të mesme, por edhe në shkollë të lartë. Legjislacioni i Sigurimeve Shoqërore i merr në mbrojtje këta persona. Sipas statistikave, në vendin tonë por edhe sipas statistikave në vende të tjera, gratë jetojnë më shumë se burrat, 6-8 vite.

Konkretisht, kur vdes bashkëshorti apo kryefamiljari, kush e përfiton pensionin familjar? E përfiton bashkëshortja në moshën 55 vjeçe, kur është pa punë, kur nuk ka tokë në pronësi apo në përdorim sipas ligjit, si edhe kur është e pavetëpunësuar. Çfarë përfiton gruaja? Në moshën 55 vjeçe, ajo merr gjysmën e pensionit të bashkëshortit. Burri mund të ketë qenë pensionist, por edhe mund të mos ketë qenë. Në rast se burri ka qenë në marrëdhënie pune, pra pa dalë në pension, atëherë për aq vite sa ka punuar ai dhe sipas rrogës që ka marrë, fillimisht fare i llogaritet atij pensioni, sikur të ishte gjallë.

Gruaja duhet të zgjedhë ndërmjet pensionit të bashkëshortit dhe pensionit të saj?

Në moshën 55 vjeçe gratë nuk marrin pension të vetin. Ta theksojmë edhe një herë: për të përfituar pension familjar një grua, së cilës i ka vdekur bashkëshorti, duhet të jetë 55 vjeçe dhe jo më pak, të mos ketë tokë, të jetë e pavetëpunësuar. Dhe do të marrë gjysmën e pensionit që do t'i takonte burrit të saj deri në ditën e fundit kur ka qenë gjallë, pra deri në ditën kur ka ndërruar jetë. Këtë pension familjar ajo do ta përfitojë deri sa të plotësojë moshën e saj për të dalë në pension pleqërie. Por, burri mund të ketë lënë edhe fëmijë të mitur ose që ndjekin shkollën. Atëherë, gjysmën e pensionit të burrit e merr gruaja dhe gjysma tjetër e pensionit të tij i jepet fëmijëve. Në qoftë se janë dy fëmijë, gjysma e pensionit ndahet sërish përgjysmë, pra 25% e merr një fëmijë dhe 25% fëmija tjetër. Në qoftë se ka lënë një fëmijë të mitur apo që vazhdon shkollën, atëherë fëmija merr 50%, pra gjysmën e pensionit të babait.

Për sa kohë vazhdon pensioni familjar?

Pensioni familjar do të vazhdojë të merret nga bashkëshortja e të ndjerit, deri sa ajo të plotësojë moshën e saj për të dalë në pension pleqërie. Në qoftë se ajo fillon punë gjatë kohës kur merr pension familjar, pra mbi moshën 55 vjeçe, por pa plotësuar moshën e saj për pension pleqërie, i ndërpritet pensioni familjar sepse do të marrë rrogë mujore nga qendra e punës. Në qoftë se kur të plotësojë moshën e saj për pension pleqërie, ajo është duke marrë pension familjar, pra nuk ka filluar ndonjë punë, atëherë asaj, ditën që i lind e drejta për të marrë pensionin e saj të pleqërisë, i lind dhe e drejta që të zgjedhë midis pensionit familjar që merr nga bashkëshorti i ndjerë dhe pensionit të saj të pleqërisë. Pra, ka të drejtë që të zgjedhën pensionin me shumën më të lartë të lekëve.

Kur ndërpritet pensioni familjar?

Pensioni familjar ndërpritet kur gruaja plotëson moshën e saj për dalje në pension pleqërie; ndërpritet kur gruaja punësohet gjatë kohës që merr pensionin familjar nga bashkëshorti që ka ndërruar jetë; ndërpritet kur gruaja ndërron jetë gjatë kohës që përfiton pension familjar; ndërpritet kur gruaja martohet përsëri dhe nënshkruan aktin ligjor të martesës, ndërsa kur bashkëjeton me një burrë tjetër por pa nënshkruar akt ligjor martese, ajo vazhdon ta marrë pensionin familjar. Sa herë që rriten pensionet në vendin tonë, me të njëjtën përqindje rriten edhe pensionet familjare. Thamë gjithashtu që gjysmën e pensionit të burrit kur ai ndërron jetë e merr gruaja, kur ajo i plotëson kushtet për të përfituar pensionin familjar dhe gjysma tjetër ndahet sipas numrit të fëmijëve që ai ka lënë, por që duhet të jenë të mitur ose duke vazhduar shkollën. Pra, kur ka lënë një fëmijë, fëmija merr 50% të pensionit; kur janë dy marrin të dy nga 25% e kështu me radhë, kur janë tre, gjysma e pensionit ndahet në tri pjesë të barabarta, e kështu me radhë. Pensionin familjar nga babai që ka vdekur, fëmijët e përfitojnë deri në moshën 18 vjeç, edhe kur nuk shkojnë në shkollë, por kur janë të papunë. E marrin deri në moshën 25 vjeç kur vazhdojnë shkollën e lartë me bursë ose pa bursë, brenda apo jashtë vendit.

Po kur vdes gruaja, a përfitojnë pension prej saj pjesëtarët e tjerë të familjes?

Siç e thashë dhe më lart, ky raport është në favor të grave, pra kemi më shumë burra që vdesin më përpara se gratë e tyre. Atëherë, kur vdes gruaja dhe ka lënë burrin e saj të papunë, pa tokë dhe të pavetëpunësuar, burri merr pension familjar nga gruaja e tij në moshën 60 vjeç, gjithnjë gjysmën e shumës së pensionit. Kushtet e tjera që duhen plotësuar nga burri për të përfituar pensionin familjar nga gruaja e tij janë të njëjta me ato që duhet të plotësojë gruaja për të marrë pensionin familjar nga burri i saj. Ky pension burrave u jepet deri në nmoshën 65 vjeç, kur ata plotësojnë moshën e plotë për pensionin e tyre të pleqërisë. Kemi dhe raste tragjike, kur të dy bashkëshortët humbin jetën. Atëherë, në rast se të dy prindërit lënë pas një fëmijë dhe kanë punuar që të dy të siguruar, fëmija deri në moshën 25 vjeç do të marrë gjysmën e pensionit të nënës dhe gjysmën e pensionit të babait. Pensionin e tërheq personi që caktohet nga gjykata si kujdestar i ligjshëm i këtij fëmije, gjithnjë në rastet kur fëmija është i mitur. Ky pension i vazhdon fëmijës deri në moshën 25 vjeç nëse ai vazhdon shkollën e lartë me shkëputje nga puna.

Cilat janë dokumentet që duhen plotësuar nga personi i interesuar, për të përfituar pensionin familjar?

Dokumentet që duhen plotësuar dhe dorëzuar janë: në qoftë se burri ka qenë pensionist në ditën kur ka ndërruar jetë, duhet libreza e tij e pensionit, certifikata e gjendjes familjare ku shënohen personat e familjes që janë në ngarkim të tij.

Na shkruan një mesazh zonja Valentina Kamberaj: "Jam 57 vjeçe. Dua të di se kur do të dal në pension. Jam siguruar për 15 vite".

Zonja Valentina do të dalë në pension rreth moshës 62 vjeçe, por më saktësisht duhet që me kartën e saj të identitetit dhe me librezën e punës të shkojë në Agjencinë e Sigurimeve Shoqërore ku do t'i bëhen llogaritë e sakta. Sipas saj, ajo ka 15 vite të siguruara, kështu që ajo e ka plotësuar minimumin e duhur të viteve të siguruara të punës që duhen për të marrë pension në vendin tonë. Ajo do të përfitojë pensionin social, i cili aktualisht është i ulët. Nëse ajo mundet le të sigurohet vullnetarisht edhe për vite të tjera, që të marrë një shifër më të lartë pensioni. Nëse ajo e plotëson moshën për të dalë në pension, atëherë nuk ka më të drejtë që të bëjë sigurime shoqërore vullnetare. Dua ta sqaroj zonjën që vite pune quhen kur ke punur që nga mosha 16 vjeçe dhe jo para kësaj moshe.

Gruaja ime ka dalë në pension pra dy viteve. Tani ka edhe një dyqan, biznes të vogël. A duhet të paguajë sigurime shoqërore?

Uroj që të punojë sa më gjatë. Sipas zotërisë, gruaja e tij ka dalë në pension në vitin 2017. Dhe për pension të plotë i janë kërkuar 36 vite punë. Vitet e punës që ajo ka punuar dhe që i janë njohur si të vlefshme, i janë shënuar në librezën e saj të pensionit. Meqenëse ajo vazhdon të punojë, është e detyruar që të paguajë kontributin e sigurimeve shoqërore sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 77, të datës 28 janar 2015. Por juve ju lind pyetja, nëse zonjës i shtohet pensioni që merr apo jo? Aktualisht zonja përfiton vlerën monetare të pensionit që i ka filluar në vitin 2017, shtesat e pensionit që i janë bërë në vitin 2018 me 2,8%, shtesa që do të bëhet në vitin 2019 me 3%, ka marrë shpërblimin prej 5.000 lekësh të rinj që përfituan pensionistët për festën e Vitit të Ri. Do të vazhdojë të paguajë kontributet e sigurimeve shoqërore. Por, ajo nuk do të marrë as edhe një lek shtesë mbi pensionin e saj të pleqërisë, nga kontributet e sigurimeve shoqërore që paguan si e punësuar në sektorin privat, megjithëse puna e saj është e licensuar sipas të gjitha rregullave e ligjeve të shtetit. Pritet që të dalë një vendim i ri i Këshillit të Ministrave, i cili është duke u diskutuar e duke u përpunuar nga anëtarët e qeverisë. Pritet të dalë brenda 3-mujorit të parë të këtij viti. Ky vendim thotë: "Të gjithë ata që kanë dalë në pension dhe që vazhdojnë të punojnë në sektorë privatë të licensuar dhe që paguajnë kontributet e sigurimeve shoqërore, për çdo vit që punojnë pasi të hyjë në fuqi vendimi i qeverisë, do të marrin një shtesë prej 2,4% mbi pensionin e tyre të pleqërisë". Pra, sqaroj edhe njëherë, për çdo vit që ata do të punojnë që nga dita kur do të hyjë në fuqi ky vendim i ardhshëm i qeverisë, e në vijim.



1975, MAO CE DUNI NË PRAG TË VDEKJES, ENVER HOXHA I KËRKON MIJËRA TON ARMATIME

DOSJA K NË REPORT TV/Pjesa e dytë e intervista së dr.Gjon Boriçit, historian i departamentit të historisë bashkëkohore në Akademinë e Studimeve Albanologjike mbi misterin e mijëra ton armatimeve që Shqipëria siguroi nga Kina gjatë viteve të miqësisë shqiptaro-kineze. Si e binden Mao Ce Dunin dhe Çu En Lain që Shqipëria ishte gjithnjë nën kërcënim për luftë. Finalaja e marrëdhënieve dhe si arriti Shqipëria të merrte nga Kina më shumë armatime edhe se Vjetnami që ishte në Luftë me SHBA-në...

Misteri i mijëra ton armatimeve të ardhur në Shqipëri nga Kina gjatë viteve të miqësisë shqiptaro-kineze u trajtua në një intervistë të historianit Gjon Boriçi në emisionin Dosja K. Dje për lexuesit e gazetës tonë, publikuam pjesën e parë të kësaj interviste, ku zbuloheshin për herë të parë sipas dokumenteve fakte të panjohura rreth kësaj ngjarje, mbi vizitat dhe bisedimet e Beqir Ballukut për të siguruar një arsenal të padëgjuar armatimesh sjellë përmes anijeve në një rrugë mjaft të ëvshtirë detare. Sot në pjesnë e dytë të intervistës, trajtohen përpjekjet e reja të Enver Hoxhës për të siguruar armatime të tjera nga Kina edhe pas shpalljes së Beqir Ballukut armik dhe ekzekutimti të tij të fshehtë. Në pjesën e dytë dr. Gjon Boriçi trajton përpjekjet e Adil Çarçanit dhe më vonë këmbënguljen e Enver Hoxhës dhe Mehmet Shehut për mijëra ton të tjerë armatime në vitin 1975. Kjo ishte tentativa e fundit e diktatorit shqiptar për të marrë armatime nga Kina, kërkesë që mori përgjigje negative.

Admirina Peçi
TIRANE

(Vijon nga dje...)

1975 NË KINË SËRISH PËR NDIHMA SHKON ADIL ÇARÇANI

Siç shpjegon historiani Gjon Boriçi, edhe në vitin 1975, Enver Hoxha, sërish i pasigurtë, i drejtoi sytë nga Kina komuniste.

"Donte sërish një kredi tjetër nga Kina dhe bëri çmos që të dërgonte përsëri Adil Çarçanin me një mision shumë të qartë, ku para se të nisej, e porositi specifikisht, duke i shpjeguar edhe gjendjen tepër të rëndë ekonomike në të cilën ndodhej vendi sepse Kina kishte reduktuar gati në minimum të gjitha ndihmat dhe kreditë ndaj Republikës Popullore të Shqipërisë, dhe e porosit duke i thënë: "Sikur edhe 5 groshë të na japin, ti merri me vrap. Ne përsëri të flasim për miqësinë e përbashkët, t'i pranojmë menjëherë", thotë historiani Boriçi, duke vijuar më tej: "Adil Çarçani shkoi përsëri në Pekin, më 14 qershor të vitit 1975. Qëndroi atje gati 3 javë. Zhvilloi bisedime të stërzgjatura me Li Hsien Jenin, i cili ishte ministër i Ekonomisë dhe një nga figurat më qendrore të Republikës Popullore të Kinës. Çu En Lai e priti shumë pak sepse ishte i sëmurë dhe pas 6 muajve ai ndërroi jetë. Li Hsien Jeni i qëndroi ftohtë dhe mjaft prerë: "Ndihma që ju keni marrë nga Republika Popullore e Kinës është disa herë më e madhe se ndihma që ne kemi dhënë për Vietnamin (duke qenë që Vietnami ishte në luftë kundër superfuqisë kryesore të botës), çfarë keni bërë me gjithë këto gjëra?". Përsëri Adil Çarçani i thotë: "Ne jemi nën rrethim. E kanë fajin armiqtë, grupi puçist i Beqir Ballukut (që nuk ishte fare e vërtetë) ka sabotuar ekonominë, ka sabotuar ushtrinë. Likuidimi i tij ishte një fitore e madhe për marksizëm-leninizmin, për Partinë e Punës dhe për qëndrueshmërinë e sistemit politik në Shqipëri", ndërkohë që Beqir Balluku kishte qenë emisar i dërguar i posaçëm tri herë në Republikën Popullore të Kinës, pikërisht për të negociuar dhe për të marrë, aq sa mundi të merrte, ndihma dhe kredi ushtarake për mbrojtjen e Shqipërisë. Li Hsien Jeni nuk ia plotësoi kërkesën siç e kërkoi Adil Çarçani. Shqipëria kishte kërkuar rreth 1 miliard e 200 milionë jen kredi. Kina i dha vetëm 500 milionë".

Është shumë interesant raporti

që Adil Çarçani (i cili firmosi sipas urdhrit të Enver Hoxhës sa hap e mbyll sytë) i bën Enver Hoxhës. Ishte një raport shumë specifik dhe aty, për herë të parë, fillon të dalë hapur teza "për mbështetjen në forcat tona". Reduktimi masiv i gjithçkaje të prodhimit, kursimi masiv, madje u shkua deri te reduktimi i ndërtimit të banesave. Normale kjo, se shumicën e ndërtimeve e kishin bërë bunkerë. Janë ndërtuar rreth 700 mijë bunkerë. Me çfarë u bënë? Dhe këtu filloi procesi i izolimit tonë. Megjithatë, përsëri Enver Hoxha, çuditërisht nuk dorëzohet. Dëshironte se s'bën që Kina t'i dërgonte përsëri armatime", thotë historiani Boriçi.

NËNTOR 1975, HOXHA-SHEHU ZGJASIN DORËN DREJT KINËS PËR HERË TË FUNDIT

Vjeshta e vitit 1975 shënon planet e fundit konkrete të Enver Hoxhës për të siguruar në Kinë sërish ndihmë ushtarake, duke e paraqitur gjendjen e Shqipërisë kritike para rreziqeve që i kanoseshin.

Siç argumenton dr. Gjon Boriçi, "më 12 nëntor të vitit 1975, Hoxha bashkë me Mehmet Shehun, firmosën një letër rreth 10 faqe, ku i kërkonin me ngulm Mao Ce Dunit që ishte ende gjallë (edhe Çu En Lai ishte ende gjallë edhe pse shumë i sëmurë. Ai vdiq në janar të vitit 1976). I shkruanin se kishin të dhëna të hollësishme që në Napoli të Italisë, Komanda e NATO-s po hartonte një projekt specifik për të sulmuar ushtarakisht Shqipërinë, gjë që nuk ishte aspak e vërtetë. Atëherë kishte ndodhur edhe procesi i Helsinkit. Ishte firmosur Karta e të Drejtave të Njeriut, ishin firmosur të tria shportat, më 1 gusht 1975. Blloku Perëndimor dhe Blloku Lindor kishin rënë në qetësi me njëri-tjetrin. Kishte filluar ajo që quhej diplomacia e organizatave joqeveritare. Kishte filluar përplasja e vlerave. Siç thoshte kancelari gjerman Vili Brand, "fitorja e Perëndimit ndaj Lindjes nuk do të vijë nga përplasja ushtarake, por do të vijë nga ballafaqimi i vlerave. Kush do të tregojë vlerat më të qëndrueshme dhe më të konsoliduara, ajo doktrinë do të fitojë", thotë hostoriani Gjon Boriçi, duke i mëshaur faktit se edhe ën



këtë situatë "Enver Hoxha kërkonte luftë, përgatitej për luftë".

"Sigurisht që nuk do të sulmonte askënd, por mania e tij për të qenë i mbrojtur, për të qenë gjithmonë i rrethuar, i armatosur, mania e tij e të qenit gjithmonë nën rrethim sikur të gjithë e kishin me Shqipërinë, kur në fakt me Shqipërinë nuk e kishte askush. E vetmja herë kur u dëgjua fort zëri i Shqipërisë, ishte kur merrej me çështjen e Kinës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe rezoluta shqiptare e 25 tetorit 1971, për pranimin e Kinës në OKB. Kaq. Por edhe largimi nga Traktati i Varshavës. Aq zë kishte Shqipëria në botë", thotë Gjon Boriçi.

Por megjithëkëtë, Enver Hoxha dhe Mehmet Shehun i shkruajnë Mao Ce Dunit se "jemi gati për t'u sulmuar dhe kërkojmë sasi të mëdha armatimi". Referuar sasisë së madhe të armatimeve që kërkonte dyshja Hoxha-Shehu nga aleati i tyre i vetëm në këtë kohë, cdokush do të mendonte se Shqipëria të nesërmen do të hynte në luftë.

Dr.Gjon Boriçi lexon një fragment nga letra e Enver Hoxhës dhe mehmet shehut. Ja çfarë kërkonin konkretisht nga Kina:

"Ky është një dokument i nëntorit të vitit 1975, i cili u dërgua me dy emisarë shumë sekretë. Njëri prej tyre ishte zëvendësministri i Punëve të Jashtme Reis Malile. Shikoni se çfarë kërkon Shqipëria. Kërkon armë të lehta këmbësorie, mitralozë, mortaja, 250.000 copë. Mortaja – 1.500, topa kundërtank – 1.500, topa fushorë – 600, artileri reaktive – 100, mitralozë kundërajrorë dygrykësh dhe katërgrykësh – 1.500, topa kundërajrorë 37 mm dhe 100 mm – 600 copë, raketa kundërtank – 1.500, raketa tokë-det – grupe 4, raketa kundërajrore të mesme – 4, raketa kundërajrore të lehta – 1.000 copë, tanke – 800 copë, transportues të blinduar – 300 copë, avionë reaktivë luftarakë dhe mësimorë – 65, helikopterë – 98 dhe vazhdon lista, e cila është shumë e gjatë, silurë – 24, anije mbiujëse, municion për armë të lehta këmbësorie – 1.450.000 copë, predha mitralozësh – 150.000.000, predha granatahedhëse – 3.000.000, mortaja etj., etj., etj. Po të shikoni këtë do të mendoni se të nesërmen do të hynim në luftë", thotë gjon Boriçi.

POR ÇFARË NDODHI PAS KËTIJ MOMENTI DHE ÇFARË PËRGJIGJE MORËN ENVER HOXHA DHE MEHMET SHEHU NGA KINA?

Dr.Gjon Boriçi thotë prerë: "Nuk erdhi asnjë përgjigje nga Kina, me shumë të drejtë. Dhe sigurisht që ky armatim nuk erdhi kurrë në Shqipëri. Ishte komplet e palogjikshme një kërkesë e tillë. Ishte jashtë çdo lloj logjike, jashtë çdo lloj realiteti. Dhe kjo ishte letra e fundit që Enver Hoxha dhe Mehmet Shehu i dërguan si komunikim dyshes kineze, Mao Ce Dunit dhe Çu En Lait. Mes tyre nuk do të kishte më komunikim sepse në janar të vitit 1976 Çu En Lai vdiq dhe më 9 shtator po të vitit 1976 vdiq edhe Mao Ce Duni. Pastaj ndihmat dhe kreditë për Shqipërinë dhe ktheu menjëherë në Kinë të gjithë specialistët kinezë që ndihmonin për ndërtimin e veprave industriale në Shqipëri. Këtu filloi pastaj procesi total i vetizolimit..".

Historiani Gjon Boriçi argumenton në fund të intervistës së tij edhe fundin e kësaj miqësie dhe periudhën e vështirë që e pasoi.

"Është një shprehje shumë e bukur, kur Shqipëria vazhdonte me atë propagandën e vet, për të treguar që ishim akoma të fortë.

Mehmet Shehu, në një miting popullor, diku në jug të Shqipërisë, thotë: "Shqipëria është një kockë e mprehtë si thikë", dhe përgjigjja e Ten Siao Pinit në rrethe shumë të ngushta, sipas ambasadorit të atëhershëm shqiptar në Pekin, Behar Shtylla, ishte: "E megjithatë, këtë kockë do ta brejnë mizat". Pastaj është e qartë historia e Shqipërisë së atyre 12 viteve deri në rënien e komunizmit, se çfarë rëniesh totale pati, në kuptimin e plotë të fjalës, në ekonomi, në kulturë, e në gjithçka tjetër. Edhe në ushtri, e cila konsiderohej si e paprekshme apo e pathyeshme.D.m.th. të kërkoje armatime të tilla, siç erdhën nga Kina, nga viti 1961, në vitin 1968, disa por jo shumë në vitet '70, thua që Shqipëria jetonte në luftë. Edhe në Vietnam, i cili ishte në luftë me superfuqinë kryesore të botës SHBA-të, prej 10 vitesh, që nga viti 1965 deri në vitin 1975, Kina nuk ka dërguar aq shumë armatime, sa ç'dërgoi në Shqipëri", përfundon historiani Gjon Boriçi.

Është e vështirë t'i japësh një përgjigje konkrete se çfarë planifikonte realisht diktatori me këto lëvizje, dhe sa e mundur ishte që të mbrohej Shqipëria e vogël kaq e ekspozuar dhe pa asnjë aleat të afër me të, me këtë arsenal armësh të pazakontë që kishte siguruar nga Kina si edhe me shpenzimet e pazakonta për projektin e bunkerizimit të vendit.

Por faktet treguan se i gjithë ky operacion i paprecedent shkoi vetëm në favor të një personi, thjeshtë për të qetësuar paranojën e diktatorit.

Delegacioni i Universitetit të Prishtinës që mori pjesë në 500-vjetorin e vdekjes së Skënderbeut, Tiranë, 1968: (nga e majta) D. Rozhaj, M. Korkuti, S. Pupovci, B. Hoxha, I. Ajeti, F. Agani

Varrezat dardane të zbuluara në Ulpianë Kosovë



Me profesor Ali Hadrin në Manastirin e Deçanit, Kosovë, 1980

Korkuti: Arkeologjia në Kosovë nuk duhet të lihet pas dore!

Dardania është pjesa më e rëndësishme e Ilirisë. Kërkimet arkeologjike në trevat antike të saj janë të domosdoshme për të plotësuar vijimësinë e etnogjenezës shqiptare

Dhurata Hamzai
TIRANE

Akademiku Myzafer Korkuti, specialist i prehistorisë dhe i arkeologjisë prehistorike shqiptare, në një intervistë për "Shqiptarja.com", ka shprehur shqetësimin e tij për lënien pas dore të arkeologjisë në Kosovë. Sipas arkeologut të njohur në vitet '50–'70 të shekullit XX janë bërë gërmime të rëndësishme në qytetet antike të Ulpianës e në Soçanicë, si dhe në disa varreza tumulare në Rrafshin e Dukagjinit etj, të cilat në vitet '80 janë kurorëzuar me bashkëpunimin me arkeologët shqiptarë, ku nga shteti komunist u dha edhe një leje për të bërë një ekspeditë të përbashkët.

Por shqetësimi i arkeologut është ndërprerja tashmë e kërkimeve arkeologjike në Kosovë, ku bëhet më i dukshëm në rastin e studimeve përmbledhëse për historinë e ilirëve dhe identitetin tonë. Korkuti është një nga autorët e tekstit "Historia e Kosovës" që po përgatitet për botim nga Instituti i Historisë së Kosovës. I pyetur për rreth këtij botimi, Korkuti u shpreh se sapo ka mbaruar një pjesë të këtij vëllimi, që titullohet "Origjina dhe territori i Dardanisë". Akademiku Korkuti krahas korpusit të veprave shkencore njihet për veprën e tij madhore "Etnogjeneza e ilirëve", ku ndriçohet një proces historik me rrjedhoja tejet të rëndësishme për historinë e lashtë të Ballkanit Perëndimor: origjinën dhe shfaqjen e ilirëve. Arkeologu nuk mund ta quaj të shkëputur vazhdimësinë iliro-shqiptare nga kërkimet arkeologjike në Kosovë, ndaj bën apel që të mos lihet pas dore arkeologjia në Kosovë. Myzafer Korkuti para një muaji është nderuar me çmimin "Aleksandër Stipçeviç" për vitin 2018, me motivimin "Për kontributin e jashtëzakonshëm shkencor shumëvjeçar në shkencat historike si specialist i prehistorisë dhe i arkeologjisë prehistorike shqiptare".

Kur keni qenë për herë të parë në Kosovë e cilat ishin arsyet, mbresat dhe kujtimet e 45 viteve më parë?

Në vitet '70 të shekullit XX marrëdhëniet midis Universitetit të Tiranës dhe Universitetit të Prishtinës njohën një zhvillim të jashtëzakonshëm. Profesorë e pedagogë nga Tirana shkuan për të zhvilluar cikle të plota ligjëratash për lëndë të veçanta sipas nevojave të fakulteteve e katedrave të ndryshme. Studiues e specialistë të fushave të ngushta u bënë pjesëmarrës, kontribuues në konferenca e simpoziume etj. Unë pata nderin e kënaqësinë që të zhvilloja ciklin e plotë të ligjëratave për lëndën e arkeologjisë në degën e historisë të Fakultetit Filologjik gjatë viteve 1973–1976, të cilat zhvilloheshin në një javë me orë të zgjatura në një semestër e një javë në semestrin tjetër. Në sesionin e provimeve paraqiteshin edhe arsimtarë, të cilët vazhdonin studimet me korrespondencë. Gjatë katër viteve kanë dhënë provimin e arkeologjisë rreth 930 studentë, të cilët për mungesë të teksteve kishin vështirësi në përgatitjen e lëndës dhe në shumë raste provimi kthehej në një bashkëbisedim.

Keni shkuar shumë herë në Kosovë për ligjërata, por edhe për t'u njohur konkretisht me monumentet e pasuritë e shumta arkeologjike të Dardanisë, si edhe me rezultatet e gërmimeve e studimeve të bëra nga shumë arkeologë të ish-Jugosllavisë.

Në vitet '50–'70 të shekullit XX janë bërë gërmime të rëndësishme në qytetet antike të Ulpianës e në Soçanicë, në shumë vendbanime të epokës së neolitit, bronzit, si dhe në disa varreza tumulare në Rrafshin e Dukagjinit etj. Sipas pikëpamjes së arkeologut J. Glishiq, territori i Dardanisë antike përbëhej nga dy krahina gjeografike, por me përbërje të ndryshme etnike. Rrafshi i Dukagjinit, sipas tij, në epokën e hekurit ka qenë e banuar nga dardanët ilirë, kurse Fushë-Kosova ka qenë e banuar nga një popullsi tjetër, e cila në pikëpamje etnike nuk ka qenë ilire. Në verë të 1980, për herë të parë u krijua mundësia, u dha leja për të bërë një ekspeditë të përbashkët të Institutit Arkeologjik të Tiranës në Muzeun e Kosovës në Kosovë, por çështja më e vështirë ishte caktimi i vendit të gërmimit, do të gërmohej në Fushë-Kosovë apo në Rrafshin e Dukagjinit. Pas shumë debatesh u vendos, me gjithë rrezikun që ekzistonte, të gërmohej në tumat e Llashticës, afër qytetit të Gjilanit, në ekstremin lindor të Fushë-Kosovës. Rezultati ishte me shumë vlerë. Riti i varrimit dhe inventari i varreve të zbuluara ishte i njëjtë me ato që ishte zbuluar në tumat e Rrafshit të Dukagjinit (Tumat e Romajt) dhe me atë të zbuluar në tumat e Kukësit e në tumat e Matit në Shqipëri. Ngjarjet e vitit 1981 në Kosovë dhe keqësimi i marrëdhënieve midis dy shteteve, ndërprenë edhe bashkëpunimin midis Universitetit të Tiranës me Universitetin e Prishtinës.

Me çlirimin e Kosovës në vitin 1999, sigurisht u krijuan kushte tërësisht të reja, si vazhdoi puna kërkimore arkeologjike pas 20 viteve ndërhyrjesh?

Gjatë viteve 2000–2005 një ekspozitë e gjerë e Institutit tonë Arkeologjik dhe e Muzeut të Kosovës ndërmori gjurmime sipërfaqësore intensive në territorin e pellgut të Drinit të Bardhë, përkatësisht në territorin e komunës së Pejës, të Deçanit, të Klinës, të Rahovecit e të Prizrenit. Një pjesë e stafit bëri sondazhe e gërmime në disa tuma e vendbanime, kështu që gjatë 6 viteve (verave) të kërkimeve e gjurmimeve në terren u evidentuan, u fiksuan e u dokumentuan 264 pika e qendra arkeologjike, shumica e të cilave janë zbulime të reja.

Pas kaq vitesh me njohjen e studimin e vlerave arkeologjike e historike të Kosovës, me çfarë po merreni aktualisht?

Si një nga autorët e tekstit "Historia e Kosovës" që po përgatitet për botim nga Instituti i Historisë i Kosovës, në fund të vitit 2018, unë përfundova një syth të këtij vëllimi, por jo të lehtë, "Origjina dhe territori i Dardanisë". Gjithashtu në fund të vitit që lamë pas, kolegji "Iliria" në Prishtinë më nderoi me çmimin "Aleksandër Stipçeviç" për vitin 2018, me motivimin "Për kontributin e jashtëzakonshëm shkencor shumëvjeçar në shkencat historike si specialist i prehistorisë dhe i arkeologjisë prehistorike shqiptare".

Profesor është e nevojshme që për lexuesin e gjerë të na thoni disa njohuri bazë për origjinën dhe territorin e Dardanisë. Deri ku shtrihej fisi ilir i Dardanëve?

-Dardania shtrihej në territorin e Kosovës së sotme, të Maqedonisë Veriperëndimore, të Serbisë Jugore dhe në një pjesë të Sanxhakut. Në gjysmën e dytë të shek. III p.e.s., në kuadër të mbretërisë hyri edhe Peonia dhe qyteti me rëndësi gjeostrategjike Bylazora (Veleshi i sotëm). Kosova, duke përfshirë edhe territorin e Shkupit, përbënte hapësirën qendrore të Mbretërisë Dardane.

Çfarë zhvillimi kishte qytetërimi dardan?

Dardania kishte një pozitë të volitshme gjeografike dhe gjeostrategjike, që mundësoi krijimin e ndërlidhjeve me hapësirat fqinje dhe ato më të largëta. Territori i saj, duke u përshkruar nga luginat e lumenjve Vardar, Drin, Moravë, Ibër dhe Sitnicë, përbënte një udhëkryq të rrugëkalimeve të rëndësishme ballkanike që shpinin drejt Egjeut, Adriatikut dhe Detit të Zi. Falë edhe pasurive natyrore (arit, argjendit, hekurit, fushave pjellore, pyjeve, kullotave), si dhe të klimës së përshtatshme, kontinentale dhe mesdhetare, Mbretëria dardane në shek. IV p.e.s. njohu lulëzimin më të madh. Dardanët janë një nga fiset e mëdha ilire. Në epokën e hekurit, ata formuan një kulturë me veçori lokale duke ruajtur tiparet e përbashkëta me kulturën ilire. Vendbanimet në këtë kohë janë ngritur në kodra gjeostrategjike, pranë burimeve përforcohen me gjerdhe apo me ledhe prej gurësh, të ngritura me teknikë të thatë. Këto vendbanime njihen sot me emrat gradina, gadisha e gradisha, disa prej tyre që banuan edhe në antikitetin e vonë e në mesjetë, njihen me toponimet gjytet dhe kala. Riti kryesor i varrimit, si në tërë trevën ilire, ishte varrimi në tuma.

Çfarë mund të na thoni për etnogjenezën e dardanëve?

-Origjina e dardanëve dhe e përkatësisë së tyre etnike është pjesë tërësore e procesit të etnogjenezës së ilirëve, si dhe e kushteve dhe e veçorive të procesit etnik të tyre. Të dhënat arkeologjike të epokës së bronzit e të epokës së hekurit dëshmojnë për një vijimësi kulturore dhe etnike të banesave të territorit të Dardanisë gjatë mijëvjeçarit të parë p.e.s. Ky përfundim mbështetet edhe nga burimet e shkruara të autorëve antikë, të cilat ndonëse të kufizuara, dëshmojnë pjesëmarrjen e Dardanisë në ngjarjet historike të kohës antike. Dardania pararomake kufizohej me Peoninë e Maqedonisë në jug, ndërsa kufiri jugperëndimor i saj ishte mali i Sharrit (Skardi), rrjedhimisht rrëza jugore e Sharrit dhe e Korabit. Kufirin veriperëndimor e formonte lugina e sipërme dhe e mesme e lumit Ibër, kurse kufirin perëndimor e formonin territoret që shtriheshin më në perëndim të rrjedhjes së Drinit të Bardhë. Përcaktimi i kufijve veriorë e lindorë të Dardanisë është më i vështirë e kërkon gjurmime më të thelluara. Nga sa mund të gjykohet mbi dëshmitë arkeologjike, rezulton se kufiri verior i Dardanisë shtrihej tej vijës kufitare të Kosovës së sotme dhe me shumë përafërsi shkonte deri në Nish. Edhe përcaktimi i kufirit lindor të Dardanisë pararomake është vështirë të përcaktohet, megjithatë duke u mbështetur në të dhënat e kufizuara, lugina e Moravës Jugore duhet të formonte kufirin lindor të Dardanisë pararomake. Etimologjia e emrit dardan, përkatësisht e Dardanisë, lidhet me glosën indoevropiane dardh-a, shqip dardha, pra vendi i dardhave. Edhe qytetet antike dardane e përcjellin zhvillimin fonetik të shqipes, si: Naissus – Nish, Scupi – Shkup, apo emrat e maleve e të lumenjve në Dardani, si: Scardus mons (Mali Sharr), Drinus (Drini) etj. Emrin Dardani ia vunë pushtuesit osmanë, duke u nisur nga emri sllavisht "Kosovopolje" (Fusha e Kosovës, që do të thotë Fusha e Mëllenjave).

PARADË FJALËKRYQESH

NGA KADRI VOKOPOLA

FJALËKRYQI **PA SKEMË**

DUHET TË NXINI **38** KUTI

	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17
1																	
2																	
3																	
4																	
5																	
6																	
7																	
8																	
9																	
10																	
11																	
12																	

HORIZONTAL

1. Që komik i famshëm
-Lewis ish-kampion i atletikës
2. Gjysma e arenës
-Është energjia… gratis
3. Chagall që qe pikor.
-Ndesh ndryshe
-Maureen që qe aktore.
4. Fillojnë një argument.
-Janë si Casanova.
5. Junior i Mel Brooks.
-Kështu fillon sfida
6. Ishin zbulimet me… ekspedita.
-Festa pa fe.
7. Inicialet e Einstein.
-Lumë në Francë.
-Theodore Dreiser
-Një mund të jetë barok.
8. Kush e kalon e tepron.
-Magnani që qe aktore.
-… Oriol i Maupassant.
9. Një pjesë ë antikitetit.
-Në fund të fundit.
-Nolde që qe piktor
-Gjysma e agimit.
10. Në krye të armatës.
-Është ai që proteston duke lënë punën.
11. Kanë shumë rezerva të tillë.
-Jepen me kushtrim.
12. … Rock në Arkansas.
-Fundi i një fatziu.
-Ilie ish-tenist.

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT PA SKEMË

B	I	S	E	D	I	M	E	T	■	T	I	F	O	Z	■	S
E	R	I	N	I	T	E	■	■	C	E	■	E	T	■	B	A
T	E	N	I	S	T	I	■	P	A	L	A	D	I	N	E	T
A	N	O	■	K	■	■	K	O	M	I	T	E	T	E	T	■
J	A	R	N	O	■	M	I	L	I	T	A	R	I	S	T	E
A	■	■	O	■	M	E	T	E	L	I	K	E	■	T	E	R
■	A	L	F	R	E	D	■	■	L	■	■	R	K	O	■	R
G	J	Y	K	A	T	A	■	D	E	M	I	■	A	R	I	E
R	■	P	E	D	A	L	E	■	R	■	N	O	T	I	■	P
E	T	E	■	A	L	J	■	T	I	R	A	N	I	■	I	T
K	U	S	A	R	I	A	■	R	■	E	T	A	■	A	N	E
U	R	I	A	■	K	■	K	O	R	R	E	N	T	E	T	■

VERTIKAL

1. Janë përzierje dentistësh.
2. Një mund të jetë unik.
-Reno aktor.
-Fund shkurti.
3. Me të bëjnë një letër.
-Një Santa në Neë Mexico.
-Një vend nisjeje.
4. Bouquet aktore.
-Rastet pa set.
5. Fillojnë vallen.
-Mund të jetë i klasit të parë në… binarë.
-Ilion Lika.
6. Rousseau, piktori që thirrej doganieri.
-Motra… e Kolë Idromenos.
7. Kryeqyteti i Turqisë.
8. Emri i inspektorit Derrick.
-Materia e trurit.
9. Inicialet e Delon.
-Është ego ime.
-Qetësonte detin.
10. Fund janari.
-Reparte Speciale këmbësorie.
-Një pjesë ë amerikanëve.
11. Janë borxhe.
-Emri i Gonçarov.
12. Një gjysmë ylli.
-Eksteme në ekstreme.
-I Preu flokët Sansonit.
13. Capirossi në motoikletë.
-Gjysma e sasisë.
14. Leonard që qe kantautor i famshëm.
-Inicialet e Mendes regjisor.
-Torta pa zanore.
15. Nuk i tregohen babait,
-Portiku i Zenonit.
-Fillojnë matanë.
16. Krerë pa kufij.
-Këndon Russians
-Inicialet e Stone aktore.
17. Shtrohet në… rrugë.
-Fillojnë tekstin.

FJALËKRYQI **SPORTIV**





HORIZONTAL

1. Skuadra që thirrej edhe The Pensioners
5. Larg në kufij.
7. Rrallë është përgjysmë
10. Dy asa
11. Iliver Hardy
12. Ray "Sugar" ish-kampion i ringut
14. Robert bomber polak
19. Një nur bukurie
20. Fise pa fe
21. Ekstreme në durim
22. Janë personale në basket
25. Franck te Milan
27. Në krye të formacion it
28. Shearer ish-bomber
29. Dy romake
30. Ndahen në barazim
31. Përfundojnë pingul
32. Pak latinisht
34. Superbike shkurt
36. Mbyllin një spital
37. Álvaro te Chelsea
41. Personazhi në foto
46. Personazhi në foto

VERTIKAL

1. Inicialet e Ancelotti-t.
2. … 9000, computeri që u çmend te 2001-Odisea në hapësirë.
3. Joachin trainer gjerman
4. Një i fundit është mat
5. Hamilton pilot
6. Thashetheme në Hollywod
7. Ka rivale Mediaset
8. Robert Redford
9. Lallana te Liverpool
12. Kështu fillon loja
13. Inicialet e Kidman
15. Hazard fantazist belg
16. Lauda ish-pilot
17. Një si kaproll
18. Andi futbollist i yni
21. Teke drite
22. Një top në rrjetë
23. Iván futbollist i yni
24. Është shahu i fundit
26. Dy anët e një elementi
27. Kush merr… mbaron
33. Jean në Formula 1
34. Portiku i Zenonit
35. Një banor i Bilbaos
36. Pak analogji
37. Gjysmë mendim
38. Harrison që qe aktor
39. Ardhje por jo dje
40. Fund tuneli
42. Mbyllin portat
43. … Kun Agüero
44. Fillojnë largimin
45. Sapo fillojnë

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT SPORTIV



SUDOKU

PLOTËSONI VENDET BOSH NË MËNYRË QË ÇDO RRESHT E KOLONË TË KETË NUMRAT NGA 1 9

	1	6	8			3		
	8						9	4
4		7	6		9	8		2
		1	7	8	6	5		9
			2		1			
6		8	4	9	5	7		
2		3	1		8	9		7
1	7						8	
		4			2	1	5	

PËRGJIGJE

9	1	2	8	4	3	6	7	5
4	8	6	1	5	7	3	9	2
3	5	7	9	6	2	4	1	8
5	4	1	3	7	8	9	2	6
7	2	8	6	1	9	5	3	4
6	3	9	4	2	5	1	8	7
1	9	4	2	8	6	7	5	3
2	7	3	5	9	4	8	6	1
8	6	5	7	3	1	2	4	9

HOROSKOPI

DASHI

Pavarësisht angazhimeve që do të keni, do të jeni të organizuar dhe do të çoni përpara gjithçka me sukses. Në mbrëmje parashikohen zhvillime interesante. Ata që janë vetëm, do të jenë shumë kërkues, lidhur me personin që duan të kenë pranë. Në punë, me ndikimin e kundër të Marsit, duhet të tregoni shumë kujdes.

DEMI

Kjo e martë parashikohet që të jetë e qetë dhe do të ndiheni gati për të organizuar diçka relaksuese, me njeriun tuaj të zemrës. Shijojeni në maksimum, këtë moment këndaqësie. Për ata që janë vetëm, parashikohen zhvillime interesante. Në punë, më në fund do arrini të vendosni disa rregulla strikte, duke rregulluar situatën me kolegët.

BINJAKET

Nëse bëni përpjekjet e duhura keni për ta forcuar edhe me shume marrëdhënien tuaj ne çift. Mundohuni edhe te shpreheni me tepër sepse do e bëni tjetri te ndihet me mire. Beqaret do jene romantike dhe te gatshëm për te bere gjithçka qe jeta t'iu ndryshoje për mire. Financat do dini si t'i organizoni me kujdes kështu qe edhe ky plan do vazhdoje te mbetet i qëndrueshëm.

GAFORRJA

Mbajini sytë hapur drejt mundësive të reja në sferën sentimentale dhe jetoni çdo gjë që do ju vijë përpara. Parashikohen të reja të rëndësishme, por edhe ndonjë problem familjar. Ata që janë vetëm, do të jenë të dominuar nga humori i mirë! Në punë, do të ndiheni të lodhur, por pavarësisht kësaj askush nuk do mund që t'iu sfidojë.

LUANI

Një klimë pozitive e yjeve do të dominojë në të gjithë sektorët e jetës. Historitë e dashurisë në krizë, do të arrijnë që të sigurojnë më shumë stabilitet. Kjo e martë është mjaft pozitive, ku nuk do të mungojnë flirtimet. Sa i takon punës do të jetë një ditë e mbushur me entuziazëm për të ardhmen, duke ndryshuar edhe ana financiare.

VIRGJERESHA

Nëse kujdeseni me tepër pe rate qe keni ne krah dhe nuk e lini vetëm për asnjë moment, gjerat do shkoje me se miri ne jetën tuaj ne çift. Beqaret do jene edhe me te privilegjuar dhe do takojnë personi n e ëndrrave. Përgatituni për emocione te papërshkrueshme. Planetët do jene aleatet me te mire ne planin financiar. Ata do iu ndihmojnë te mos keni asnjë vështirësi.

PESHORJA

Për gjithë ata që janë në çift, dashuria do të jetë e mbushur me zhvillime pozitive. Ky është një moment i mirë për të ndërtuar të ardhmen në çift. Ndërsa gjithë ata që janë vetëm, do të kenë mundësi për takime të reja. Në punë do ju duhet të bëni disa zgjedhje të rëndësishme për të ardhmen tuaj.

AKREPI

Do të ndjeni nevojën për tu përfshirë në emocione të reja dhe për të dalë nga rutina. Merrni një periudhë kohe vetëm për veten tuaj! Pritet rikthim intensiteti me partnerin/en. Edhe ata që janë vetëm, do të ndjejnë emocione të papritura. Në sferën profesionale duhet të bëni kujdes, lidhur me financat. Prisni momentin e duhur, për të bërë investime të rëndësishme.

SHIGJETARI

Në dashuri nuk do të ndjeni atë intensitetin special që bashkon dy zemrat. Por e marta do të sjellë zhvillime të rëndësishme sa i takon disa miqësivr të reja. Yjet favorizojnë ata që janë vetëm, ku parashikohen flirte interesante. Në punë, në sajë të ndikimit të Uranit do të rezultoni të besueshëm për dikë që është në vështirësi.

BRICJAPI

Kjo është dita e duhur për ti dhënë një shtysë të rëndësishme një historie dashurie të cilën nuk e keni të qartë. Rruga është e hapur drejt konsolidimit ose krizës. Ata që janë vetëm, mund të përfshihen në aktivitete me persona që do ju zgjojnë interesa të reja. Në punë, gjithçka ecën siç ju dëshironi, ndonëse ndjeni nevojën për të konsoliduar pozitën tuaj.

UJORI

Hëna do të ketë ndikim aspak të favorshëm sa i takon ndjenjave. Me partnerin/en do e keni shumë të vështirë që të gjeni intensitetin. Ata që janë vetëm, duhet të tregojnë kujdes, ndaj një raporti të kaluar. Sa i takon sferës profesionale, do të vlerësoheni maksimalisht për rezultatet e arritura.

PESHQIT

Kjo e martë kërkon që të reflektoni mirë, pasi ka ardhur momenti që të merrni vendim lidhur me raportin në çift. Për ata që janë vetëm, ky nuk është një moment i mirë, por fatmirësisht do të jeni të rrethuar nga miq të sinqertë. Në sferën profesionale, pas shumë pritjesh, do të arrini të merrni kënaqësitë e shumë pritura.

FJALEKRYQI **I KRIPTOGRAFUAR**

6 S	8 T	2 A	10 D	■	■	10	12	■	6	5	12	10
1	4	■	5	18	4	3	13	8	5	8	■	2
■	9	4	12	4	9	2	7	5	■	2	■	9
■	■	10	4	12	2	9	4	16	5	■	16	2
■	16	2	9	2	8	2	■	■	7	5	2	3
3	2	6	■	16	15	8	5	7	2	■	3	5
5	6	14	■	13	3	4	20	4	■	6	8	8
2	8	15	■	8	4	16	■	3	10	■	2	■
7	13	3	■	5	■	5	■	4	3	2	■	6
4	3	4	■	16	11	■	5	16	4	18	4	8
6	4	■	16	2	17	4	12	5	8	4	■	2
8	■	17	5	8	4	9	4	■	2	■	2	3

PËRGJIGJE

■	L	■	M	A	L	■	T	R	E	N	A	T
H	I	P	O	T	E	Z	A	T	■	O	D	A
A	M	A	T	O	R	E	T	■	S	L	■	L
T	A	K	I	M	E	T	■	E	P	I	K	E
A	■	I	V	I	■	A	■	P	I	■	A	T
■	■	C	E	■	A	■	D	I	T	A	R	I
I	N	A	T	E	T	■	I	T	A	L	O	■
R	I	T	■	L	L	■	T	E	L	A	T	■
A	V	■	A	L	E	■	E	T	I	■	A	L
■	E	N	T	E	T	■	T	E	■	A	T	A
E	L	I	O	■	E	D	■	T	E	K	■	L
T	E	R	M	E	T	E	T	■	S	A	R	A

SHKRONJA E NJËJTË PËR NUMËR TË NJËJTË

Alba MALLTEZI **DREJTORE E PËRGJITHSHME E FREE AND FAIR MEDIA GROUP ;** Aurel PEPA ***KRYEREDAKTOR***
Genc KONDI ***ADMINISTRATOR I PËRGJITHSHËM*** ; Admirina PEÇI ***KRYEREDAKTORE E "RILINDASI" ;***
LAYOUT & DESIGN : Altin ALIAJ, ***SHPËRNDARJA:*** Spiro MESHINI ***CEL:*** +355696088847

Departamenti i Marketingut: Patricia Costantinescu
Cel: +355696060419 - *marketing@shqiptarja.com*

Redaksia: Rruga: "Dervish Hima" tre kullat, kulla e dytë Tiranë. ***E mail:*** shqiptarja.com@hotmail.com ***Ëebsite:*** ëëë.shqiptarja.com ***Mobile:*** +355696060421 Shtypur në shtypshkronjën: KLASS shpk, Rruga 5 Maji, Tiranë

Presidenti, Ilir Meta, duke vendosur lule tek busti i Ismail Qemalit

Përkujtohet 100-vjetori i vdekjes së Ismail Qemalit

Ismail Qemali ishte firmëtari i parë i Deklaratës së Pavarësisë dhe kryeministri i Qeverisë së Parë të Shqipërisë. Në nder të tij homazhe janë zhvilluar në Tiranë dhe në Vlorë.

Në 100- vjetorin e ndarjes nga jeta të atit të Pavarësisë, Ismail Qemalit janë zhvilluar dje homazhe në shtatoren e tij Tiranë nga Bashkia dhe presidenti Ilir Meta. Nderime të shumta kanë ardhur edhe nga politikanë nga Kosova. Ndërsa në Vlorë, në qytetin ku Qemali shpalli pavarësinë të pranishëm në homazhe ishin kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi, kryebashkiaku i Vlorës, Dritan Leli, deputetë, etj. Ishte pranishme dhe ministrja e Kulturës, Eva Margariti e cila përcolli edhe fjalën e kryeministrit Edi Rama. Në fjalën e tij, kryebashkiaku i Vlorës Dritan Leli u shpreh se: Historia fillon këtu në Vlorë në mbështetjen e këtij burrit të madh, pasi mënyra që bëri ai shqiptarët bashkë, meriton të përulemi. Ai themeloi historinë modern të popullit tonë, dhe qëndron në piedestalin e të gjitha figurave që ka nxjerrë populli shqiptar. Ndërkohë ministrja Margariti ka bërë përshëndetjen në emër të kryeministrit Rama. Ajo është shprehur se: Asnjë nuk i afrohet Ismail Qemalit. Ishte një apoteozë madhështore e të gjithë popullit, një kurorë që ai e fitoi duke u përpjekur deri në frymën e fundit për njerëzit. Qeveria e Vlorës ishte e para që e kuptoi që arti, dija, ndriçimi i mendjes dhe kultura ishin ato që do ta bënin Shqipërinë në një vend të përparuar dhe të begatë.

PRESIDENTI META: PËRULEMI PARA VEPRËS SË TIJ

Presidenti Ilir Meta ka vendosur lule tek shtatorja e Ismail Qemalit në Tiranë me rastin e 100-vjetorit të ndarjes së tij nga jeta. Për mediat e pranishme, presidenti Meta u shpreh se: "Sot është momenti jo vetëm të përkulemi përpara veprës së tij, por edhe të angazhohemi për forcimin e shtetit shqiptar për ruajtjen dhe lartësimin e simboleve tona kombëtare, por njëkohësisht edhe për përmbushjen e ëndrrës së tyre për një Shqipëri plotësisht europiane.", tha Meta.

PRESIDENTI I KOSOVËS: ISAMIL QEMALI BURRËSHTETAS VIZIONAR

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi ka nderuar figurën e Ismail Qemalit në 100 vjetorin e ndarjes së tij nga jeta. "Para një shekulli pushoi së rrahuri zemra e diplomatit të shquar Ismail Qemali, themeluesit të shtetit shqiptar. Pas aktit të shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, Ismail Qemali u dëshmua si burrështetas vizionar, duke vënë themelet e shtetit mbi vlera perëndimore. Ismail Qemali hyn në radhën e burrështetasve më të mëdhenj të kombit shqiptar,"-shkruan Thaçi.

HARADINAJ: ISMAIL QEMALI, IKONA E PAVARËSISË SONË

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj shktuan se: "Sot një shekull më parë vdiq strategu themelues i shtetit modern shqiptar, Ismail Qemail Vlora, i cili iu la shqiptarëve trashëgiminë e përjetshme, Shqipërinë e mëvetësishme. Frymëzim për atdhetarët, udhërrëfyes dhe emblema e Shqipërisë, si kryetar i parë i Qeverisë shqiptare, bashkoi shqiptarët që të rreshtohen me idealet e lirisë, për një shtet të bazuar në vlerat Perëndimore. I përjetshëm kujtimi për shtetformuesin, ikonën e pavarësisë sonë!,"

VELIAJ: ISMAIL QEMALI, THEMELUESI I SHTETIT TONË MODERN!

Me rastin e 100-vjetorit të ndarjes nga jeta të atit të Pavarësisë së Shqipërisë, Bashkia e Tiranës vendosi në nderim të tij buqeta me lule pranë shtatores së Ismail Qemalit në bulevardin "Dëshmorët e Kombit". Lidhur me përvjetorin kryebashkiaku Erion Veliaj shkruan: 100 vjetori i vdekjes se Ismail Qemalit - autor i pavarësisë dhe themeluesi i shtetit tone modern! Sot lule ne monumentin e tij dhe aktivitete ne të gjithë Tiranen për te kujtuar veprën e plakut te urte. Rroftë Shqipëria.

"45 MINUTA" NË REPORT TV

Ferit Duka: Ja kush e mbështeti Ismail Qemalin për Pavarësinë e Shqipërisë

Historiani Ferit Duka në emisionin "45 minuta" të gazetarit Denis Minga në Report Tv

Ftuar në emisionin "45 minuta" të gazetarit Denis Minga në Report Tv, historiani Ferit Duka analizon arsyet se pse ishte Ismail Qemali njeriu që guxoi të ngrinte flamurin e pavarësisë në Vlorës në 28 nëntor 1912. Duka ndalet te profili i "babait të pavarësisë" si shtetar i cili vinte nga një përvojë e theksuar në Perandorinë Osmane.

"Vinte nga një familje nacionaliste dhe patriotike. Tradita e familjes ka të bëjë shumë. Së dyti, ka bërë një karrierë të jashtëzakonshme në shtetin osman, në atë perandori. Ishte në krah të mitat pashës, babait të kushtetutës otomane që në vitet 1800. Pati edhe pasoja., Mitat Pasha u ekzekutua, u mbyll parlamenti osman dhe Ismail Qemali i vuajti këto pasoja. Por ishte një shkollë e madhe që u kalit edhe më shumë. Ishte në të gjitha mbledhjet e patritotëve për alfabetin shqip. Kishte marrë edhe të drejtën që të përgatiste raporte për çështje esenciale të Perandorisë Osmane. Në 1 majin e vitit 1900 kur Ismail Qemali e pa se brenda kupolës perandorake e pa se nuk kishte më vend për një njeri me pikëpamje të tilla si të tijat, vendosi të kalojë në perëndim.

Ka bërë një jetë me sakrifica të pashembullta, ndiqej nga shërbimi osman. Ka jetuar në Zvicër, paris, Londër, në shumë vende të Europës. Ka qenë pak anglofil, kishte njohje me rrethet e larta britanike dhe me figurat e tjera të Europës. Por Anglia e ndihmoi edhe për arratisjen nga shteti osman dhe më pas më vonë kur erdhi puna që ndodhën ngjarjet e vrullshme të 1912 me shpërthimin e luftës ballkanike, kur u kuptua që osmanët s'kishin më të ardhme në ballkan fqinjët u sulën ndaj tokave shqiptare, serbët, grekët, Mali i Zi. Në këtë rrëmujë e sipër, Ismail Qemali ishte edhe diplomat, njeri i politikës, njihte mirë administratën osmane. Ishte ai që mori përsipër këtë marrë të madhe të themelimit të shtetit shqiptar. Faik Konica, Fan Noli, Mid'hat Frashëri, ishin patriotë, intetelektualë, por nuk ishin shtetarë.

Ismail Qemali kishte dimensionin e shtetarit, të diplomatit. Po të shihni deklaratat e tioj ngha 1900 e këtej janë shumë të kujdesura dhe të qendisura. Çështjen kombëtare e shihte të lidhur ngushtë me konjukturat diplomatike dhe politike të kohës. Deri në fund kur krijohen kushtet për luftën ballkanike, atëherë Ismail Qemali nisi shpejt aksionin për të shpallur shtetin shqiptar të pavarur. Ismail Qemali ka një kontribut esencial në këtë çështje. Pavarësia si akt nuk mund të shkëputet për asnjë moment nga i gjithë sfondi historik nga i cili u zhvillua", u shpreh Duka.

Por a kishte mbështetje të jashtme Ismail Qemali? "Austro-Hungaria dhe Italia, dhe pas tyre Gjermania. Ishin shtetet që e ndihmuan Ismail Qemalin të shpallte pavarësinë e Shqipërisë. Anglia ishte më e larguar. U tregua në konferencën e ambasadorëve në Londër, Eduart Greei, ministër i jashtëm britanik, mbajti një qëndrim ekuilibriues, edhe pse i përkiste bllokut të Antantës ku hynte edhe Rusia që përkrahte sllavët. Qëndrimi i tij ishte i drejtpeshuar. Kontribuoi në ruajtjen e ekuilibrave që të mos shkonte më keq ky vendim në lidhje me çështjen shqiptare, më 29 korrik 1913, që shpalli Shqipërinë të pavarur por gjysmën e territorit e la jashtë", theksoi historiani Ferit Duka.

Pavarësisht shpalljes shtet sovran dhe i pavarur në ditën historike të 28 nëntorit 1912, shqetësimet për territorin shqiptar nuk kishin të ndalur. Vetëm disa muaj pas mëvetësisë si një dhe i pandarë, Konferenca e Ambasadorëve në Londër në korrik 1913, vendos ndryshimin e kufijve dhe për rrjedhojë gjysma e territorit mbetet jashtë kufijve zyrtarë. Shqipëria u penalizua edhe nga lëvizjet e brendshme, një prej tyre, thotë historiani Ferit Duka, ishte lëvizja esadiste e Esat Pashë Toptanit.

"Shteti shqiptar ishte si një foshnje e lindur në ditë të vështira që nuk e mori veten kurrë. Po ecej drejt konfliktit të madh botëror. Në ballkan kjo kishte rrezatime të tmerrshme. Qeveria e Ismail Qemalit vërtetë ishte akti i madh i shpalljes së pavarësisë, por ishte një qeveri në rrethim, e ngushtuar. Me këtë rezonoi edhe faktori i brendshëm, përçarja. Dhe një prej këtyre ishte Esat Pasha me veprimtarinë e tij. Kjo shkoi kundër rrymës së interesit kombëtar. Ismail Qemali e afroi në qeveri, e shfrytëzoi këtë bonus në Europë dhe loboi për veten. Sapo u kthye prej andej krijoi senatin e Shqipërisë së mesme, një pol të dytë kundër interesave shqiptare. Iu kundërvu qeverisë me armë dhe në zonat e Elbasanit është bërë një luftë e tmerrshme mes esadistëve dhe forcave qeveritare", shton më tej historiani Ferit Duka.